



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 303 Akti

Nr. 394 Vendimi  
Tiranë, më 7.6.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Brunilda Bekteshi</b>	Kryesues
<b>Olsi Komici</b>	Relator
<b>Roland Ilia</b>	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 7.6.2021, ora 09:30, në Pallatin e Koncerteve, (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Valbon Çekrezi**, aktualisht gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Valbon Çekrezi, vëzhguesen ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore publike në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Valbon Çekrezi, i cili kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Subjekti i rivlerësimit Valbon Çekrezi, ushtron detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtuar rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit u është nënshtuar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.3.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, short nga i cili rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 3, i përbërë nga komisionerët Brunilda Bekteshi, Alma Faskaj dhe Roland Ilia. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionere Alma Faskaj.

3. Komisioni me vendimin nr. \*\*\*, datë 10.4.2020, vendosi rishpërndarjen e çështjeve të komisioneres Alma Faskaj dhe nga procedura e shortit u caktua si komisioner relator, komisioneri Olsi Komici.

4. Me vendimin nr. 1, datë 26.5.2020, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Valbon Çekrezi, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe rivlerësimin e aftësisë profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Brunilda Bekteshi. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes.

Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar znj. Marie Tuma.

5. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim, Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim, ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim, DSIK) dhe Grupi i Punës në Këshillin e Lartë Gjyqësor (në vijim KLGj).

Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.

6. Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes, janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

7. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 11.5.2021, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht

për subjektin e rivlerësimit Valbon Çekrezi, si dhe njoftimin e tij për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

**8.** Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 11.05.2021 mbi përbërjen e trupit gjykues, rezultatet e hetimit, mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e përfuara nga hetimi kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

**9.** Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me rezultatet e hetimit në datën 21.5.2021, ka dërguar nëpërmjet postës elektronike pranë Komisionit prapësimet dhe provat për rezultatet e hetimit të dërguara nga Komisioni. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit në datën 24.5.2021 dërgoi përsëri disa shpjegime dhe prova shtesë nëpërmjet postës elektronike.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**10.** Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë në rrugë elektronike nga Komisioni në datën 24.5.2021.

**11.** Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, datë 3.6.2021, ora 10:00, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma.

**12.** Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit Valbon Çekrezi, u paraqit personalisht, parashitroi shpjegimet e tij dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

## **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**13.** Z. Valbon Çekrezi ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Subjekti ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**14.** Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

**15.** Për subjektin e rivlerësimit Valbon Çekrezi, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshin të tria kriteret: (1) vlerësimin e pasurisë; (2) kontrollin e figurës; si dhe (3) vlerësimin e aftësive profesionale.

**16.** Pavarësisht se në kreun IV të ligjit nr. 84/2016 2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me këtë vlerësim pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetues dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një

proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

### **A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

**17. ILDKPKI-ja**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 11.5.2018, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Valbon Çekrezi, i cili është subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së që prej vitit 2003, me numër indeksi \*\*\*, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “ Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

**18.** Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2010 deri në vitin 2016 dhe referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë - shtojca 2 në datën 25.1.2017. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për çdo pasuri të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ILDKPKI-ja ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*

### **A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

**19.** Bazuar në ligjin nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Referuar neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- b) deklaratën e pasurisë - shtojca 2 dhe deklaratat periodike të pasurisë ndër vite;
- c) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkresore/dokumentet, të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, si nga: Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Banka e Shqipërisë dhe të gjitha bankat e nivelit të dytë, drejtoritë vendore të Kadastrës, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, drejtoritë rajonale të tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., shoqëria “Ujësjellës-Kanalizime” sh.a., zyra noteriale, DRSSH-të etj.;
- e) deklaratimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- f) shpjegimet me shkrim të subjektit, si dhe shpjegimet në seancën dëgjimore.

**20.** Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, si dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të

mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të pasurive në pronësi apo përdorim; dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë situatë konflikti interesi, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

**21.** Në lidhje me dorëzimin e deklaratës së pasurisë - shtojca 2, në zbatim të nenit 31/1<sup>1</sup>, rezulton se subjekti i rivlerësimit Valbon Çekrezi, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (duke përfshirë edhe personat e lidhur me të), në bazë të ligjit nr. 84/2016, në datën 25.1.2017, brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi.

Pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë - shtojca 2.

### **Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit**

**1. Apartament me sipërfaqe 137.4 m<sup>2</sup>** me adresë: Njësia Bashkiake Nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, kompleksi “\*\*\*\*”, Tiranë, blerë me kontratën nr. \*\*\*, datë 31.7.2008, me çmimin 10,895,820 lekë, me pjesë takuese 100%.

**Burimi i krijimit:** (a) vlera 3,384,280 lekë përfituar nga shitja e apartamentit ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Elbasan me kontratën e datës 11.7.2008<sup>2</sup> (apartamenti blerë nga Enti Kombëtar i Banesave Elbasan me kontratën nr. \*\*\*, viti 2001, me vlerë 556,265 lekë, vlerë e cila përbën diferencën mes vlerës së këtij apartamenti dhe vlerës së apartamentit të përfituar nga privatizimi i banesave shtetërore me kontratën e privatizimit, datë 30.8.1993, të ndodhur në lagjja “\*\*\*\*”, Elbasan); (b) vlera 50,000 euro marrë kredi nga “Alpha Bank” me kontratën e kredisë së datës 29.8.2008; (c) diferenca nga të ardhurat ndër vite.

### **Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni**

**1.1** Në deklaratën pasurisë të vitit 2008 (në vijim DIPP), subjekti ka deklaruar: “*Blerë apartament me sip.137.4 m<sup>2</sup> me adresë rr. ‘\*\*\*\*’ (S., Tiranë), në shumën 10,895,850 lekë, pjesërisht kredi në vlerën 50,000 euro tërhequr nga Alpha Bank*”.

**1.2** Subjekti ka depozituar: (i) kontratën e shitblerjes, datë 31.7.2008<sup>3</sup>, me shitës L.K. dhe blerës Valbon Çekrezi për apartamentin me sip. 137.4 m<sup>2</sup> i ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, kompleksi “\*\*\*\*”, 3+1, k. \*\*\*, ap. \*\*\*, si dhe sipërfaqje shërbimi 11.7 m<sup>2</sup>, Tiranë, për çmimin 10,895,820 lekë, shumë të cilën blerësi e ka likujtuar tërësisht jashtë zyrës noteriale; (ii) vërtetim hipotekor, datë 25.8.2008, për apartamentin e mësipërm, në pronësi të z. Valbon Çekrezi.

**1.3** Në lidhje me historikun e pronësisë mbi këtë apartament, subjekti ka shpjeguar se apartamentin me sip. 137.4 m<sup>2</sup> e ka blerë nga shitësi L.K. në bazë të kontratës së shitjes së datës 31.7.2008.

**1.4** Shoqëria \*\*\* sh.p.k., nga korrespondenca e kryer,<sup>4</sup> ka konfirmuar se nuk ka lidhur asnjë kontratë sipërmarrje/aktmarrëveshje/kontratë shitje me shtetasin Valbon Çekrezi jo vetëm në rrugën “\*\*\*\*”, por edhe në asnjë vend tjetër, ku kjo shoqëri ka ndërtuar. Kjo shoqëri ka konfirmuar se subjekti Valbon Çekrezi e ka blerë apartamentin në fjalë nga njëri prej pronarëve të truallit, i

<sup>1</sup>Subjekti i rivlerësimit ka detyrim të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë pranë ILDKPKI-së.

<sup>2</sup>Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 11.7.2007.

<sup>3</sup>Kontrata nr. \*\*\*, datë 31.7.2008.

<sup>4</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.11.2020, nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.

cili e ka marrë këtë apartament nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. në këmbim të truallit në bashkëpunimin me shoqërinë për një projekt përkatës.

**1.5** Gjithashtu, nga Komisioni është administruar dhe kontrata e shkëmbimit, datë 9.10.2006<sup>5</sup>, e përcjellë nga notere E.T. me palë shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe bashkëpronarët e familjes K., L.K. etj., me objekt shkëmbimin e pasurive të paluajtshme ndërmjet tyre, ku ata janë bashkëpronarë të një sipërfaqeje 4300 m<sup>2</sup> truall, në S., Tiranë. Sipas kësaj kontrate, nga procedura e shkëmbimit, një nga bashkëpronarët e truallit, z. L.K., do të përfitojë në pronësi apartamentin me sip. 137.4 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, k. \*\*\*, në rrugën “\*\*\*\*”.

**1.6** Komisioni me pyetësin nr. 2 ka kërkuar nga subjektit të provojë me dokumentacion ligjor pagesat për apartamentin në vlerën 10,895,820 lekë.

Subjekti ka shpjeguar se: *“Shuma prej 80,000 euro ka kaluar në favor të shitësit nëpërmjet llogarisë bankare në ‘Alpha Bank’ në datën 9.9.2008. Si burim për shumën 80,000 euro ka shërbyer depozitimi i datës 11.7.2008, në shumën 30,000 euro, shumë kjo e krijuar nga konvertimi i shumës së përfitur nga shitja e banesës në Elbasan 3,384,280 lekë dhe një pjesë të kursimeve si dhe kredia e disbursuar në datën 3.9.2008, në shumën 50,000 euro e marrë nga ‘Alpha Bank’. Po në datën 9.9.2008 është bërë dhe likuidimi i diferencës së mbetur të çmimit të apartamentit në shumën prej 1,116,000 lekë, pagesë e kryer jashtë zyrës noteriale dhe ka si burim kursimet nga të ardhurat personale”.*

**1.7** Subjekti ka depozituar dhe deklaraten noteriale të datës 23.11.2020<sup>6</sup> me deklarues z. L.K., i cili deklaroi se i ka shitur z. Valbon Çekrezit një apartament me çmimin 10,895,820 lekë me kontratën e datës 31.7.2008 dhe çmimi është paguar në dy këste: (a) në datën 9.9.2008 është paguar shuma 80,000 euro (9,780,000 lekë) në llogarinë bankare në “Alpha Bank”; dhe (b) diferenca në shumën prej 1,160,000 lekësh është paguar me mandatarkëtimin nr. \*\*\*, datë 9.9.2008.

**1.8** Komisioni ka hetuar edhe mbi ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me shtetasin L.K. dhe me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., duke kryer korrespondencën përkatëse me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Gjykatën e Apelit Durrës dhe nga hetimi i kryer nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.

**1.9** Komisioni analizoi shpjegimet e subjektit në lidhje me pagesat e kryera për blerjen e apartamentit.

Për depozitimin në bankë të shumës 30,000 euro në datën 11.7.2008, me kundërvleftë në shumën 3,657,000 lekë, sipas kursit të këmbimit të euros (1 euro = 121.9 lekë), subjekti ka përdorur të ardhurat nga shitja e apartamentit në Elbasan, në vlerat 3,384,280 lekë dhe 272,720 lekë nga kursimet *cash* të deklaruara në DPV-në e vitit 2007.

“Alpha Bank” konfirmon transfertën bankare për pagesën e kryer në datën 9.9.2008, në shumën 80,000 euro, nga llogaria e subjektit të rivlerësimit në llogarinë bankare të shitësit.

**1.9.1** Subjekti, në pyetësin nr. 3, ka deklaruar se: *“Përdorur nga gjendja cash e akumuluar, shuma 1,000,000 lekë, për arredim etj.”.*

<sup>5</sup>Kontratë shkëmbimi nr. \*\*\*, datë 9.10.2006.

<sup>6</sup>Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 23.11.2020, me deklarues L.K.

Gjithashtu, përgjatë hetimit subjekti ka deklaruar se shpenzimet e mobilimit për apartamentin në fjalë të kryera prej tij në vitin 2008 janë në shumën 800,000 lekë dhe se për këtë ka përdorur edhe huan e marrë nga teza e tij, në shumën 400,000 lekë.

Në këto kushte, duket se subjekti ka shpenzuar nga kursimet e deklaruara *cash* shumën 400,000 lekë për mobilim. Në datën 9.9.2008, në momentin e kryerjes së pagesës *cash*, subjekti ka pasur në dispozicion nga kursimet e tij ndër vite: shumën 1,350,000 lekë (gjendja *cash* 2007) -272,720 lekë (përdorur për të plotësuar shumën 30,000 euro) -400,000 lekë (mobilim) = 677,280 lekë.

Për të plotësuar diferencën prej 438,720 lekësh (1,116,000 - 677,280), subjekti ka përdorur të ardhurat e krijuara nga paga e tij deri në momentin e kryerjes së pagesës. Sipas analizës së kryer nga Komisioni, duket se subjekti ka pasur mundësi që deri në datën 9.9.2008 të kursejë nga pagat e vitit 2008 shumën 527,864 lekë<sup>7</sup>, e cila është e mjaftueshme për të mbuluar shumën që nevojitet për të plotësuar pagesën totale prej 1,116,000 lekësh.

**1.10** Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ kryesisht, ka konstatuar se:

a) Kredia në “Alpha Bank” është marrë nga subjekti i rivlerësimit në datën 29.8.2008, pra, pas rreth një muaj nga data e blerjes së apartamentit prej subjektit me kontratën e shitblerjes së datës 31.7.2008, ndërkohë, që subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kredia e marrë në shumën 50,000 euro është përdorur për blerjen e apartamentit.

b) Çmimi i blerjes së apartamentit i është paguar blerësit në datën 9.9.2008, mbi një muaj pas lidhjes së kontratës së shitblerjes.

**1.10.1** Në lidhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe në shpjegimet e dhëna në seancën dëgjimore, ka shpjeguar, ndër të tjera, se: “[...] *pagesa prej 10,895,820 lekësh është bërë tërësisht në datën 9.9.2008, ku 80,000 euro janë kaluar në favor të shitësit nëpërmjet llogarisë bankare në ‘Alpha Bank’, ndërsa diferenca prej 1,116,000 lekësh është bërë cash (në dorë) kundrejt lëshimit nga shitësi të dëftesës (mandatarkëtimi).*

*[...]me shitësin kam rënë dakord për blerjen e apartamentit dhe për çmimin, duke i bërë të ditur se disponoja një pjesë të çmimit, ndërsa për një pjesë tjetër të tij, vlerën 50,000 euro, do të merrja kredi bankare në ‘Alpha Bank’, por për marrjen e të cilës banka kërkonte garanci/hipotekë, ndërkohë, që unë nuk kisha ndonjë pasuri të paluajtshme për ta vënë në hipotekë në favor të bankës. Ndodhur në një situatë të tillë, ndërsa ishte i interesuar ta shiste apartamentin dhe pas bisedave ai krijoi besim ndaj meje, besoj ka ndikuar dhe qenia ime në marrëdhënie pune dhe për këtë shkak mundësia që kisha për të plotësuar kërkesat e tjera të bankës për marrjen e kredisë, shitësi pranoi që përmes kontratës së shitjes të më kalonte pronësinë e apartamentit, me qëllim që unë të plotësoja edhe kërkesën e bankës për hipotekë, çka do të bënte kështu të mundur marrjen nga unë të kredisë bankare dhe, më tej, likuidimin tërësisht të çmimit. Sikurse kam rënë dakord me shitësin, menjëherë pas lidhjes së kontratës kam aplikuar për regjistrimin e saj, gjë e cila ka ndodhur vetëm në datën 25.8.2008, pasi ka qenë muaji gusht dhe shërbimet në zyrën e regjistrimit kanë qenë të reduktuara. Po ashtu, kam aplikuar edhe për kredinë bankare destinacioni i të cilës është, pikërisht, për blerje apartamenti, por miratimi i kredisë nga banka është kushtëzuar nga akti i regjistrimit të apartamentit në pronësinë time, ndërsa atë duhet ta vendosja në hipotekë në favor të bankës. Pas regjistrimit të apartamentit në pronësinë time, disa ditë më pas, në datën 29.8.2008, arrita të lidh kontratën e kredisë bankare për vlerën 50,000 euro, kredi e cila u*

<sup>7</sup>Të ardhurat nga pagat (986,615 lekë) - shpenzime jetike për 8 muaj (182,160 lekë) - pagesë kredie (57,758 lekë) - shpenzime udhëtimi (146,667 lekë) 128,333 lekë = 527,864 lekë mundësia për kursim deri më 9.9.2008.

*disbursua më 3.9.2008. Pas kësaj, në datën 9.9.2008, kam bërë likuidimin tërësisht të çmimit në favor të blerësit. Dua të sqaroj se në atë kohë, pra, kur kam lidhur kontratën e shitjes, jam fokusuar të arrij blerjen e apartamentit, dokumentimin e rregullt të blerjes, si dhe sjelljen me korrektesë dhe mirëbesim ndaj shitësit në lidhje me pagimin e çmimit. Kam menduar se mënyra e zgjedhur bashkërisht me shitësin nuk krijonte ndonjë problematikë për mua edhe në raport me deklarimin e pasurisë, gjë që e kam bërë rregullisht. Referuar faktit që më kërkohen shpjegime për këtë transaksion, për ta shmangur një gjë tillë, mbase me shitësin mund të kishim gjetur ndonjë zgjidhje tjetër ligjore. Megjithatë, me shitësin kemi menduar që ajo ka qenë një zgjidhje e ligjshme dhe e mirë për të dy, duke e respektuar me korrektësi dhe duke mos patur asnjëherë keqkuptime”.*

### **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

**1.12** Komisioni vlerëson se pavarësisht se pala shitëse dhe ajo blerëse (subjekti i rivlerësimit) kanë shprehur vullnet të vesuar përpara noterit në kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 31.7.2008, duke e pasqyruar çmimin e blerjes së apartamentit me sip. 137,4 m<sup>2</sup>, si të paguar tërësisht nga ana e blerësit jashtë zyrës noteriale, ndërkohë që pagesa e çmimit të apartamentit është kryer rreth një muaj e 10 ditë më pas, dokumentacioni bankar, përfshirë atë të kredisë, si dhe akumulimi dhe transferimi i shumës prej 80,000 euro nga llogaria e shitësit te llogaria e blerësit, veprimet e ASHK-së Tiranë, deklarata noteriale e lëshuar nga blerësit që konfirmon çmimin e shitjes së apartamentit dhe pagesat e kryera nga ana e shitësit, si dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit përgjatë hetimit dhe në seancë dëgjimore, krijojnë bindjen e plotë se në asnjë rrethanë subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer dhe nuk ka tentuar të kryejë ndonjë deklaram të rremë në lidhje me pagesën e çmimit të blerjes së apartamentit, gjithashtu, nuk ka fshehur dhe nuk ka tentuar të fshehtë burime financiare të paligjshme që do të mund të përdreshin për blerjen e këtij apartamenti.

Komisioni arrin në përfundimin se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë pasurinë apartament me sip. 137.4 m<sup>2</sup> në rrugën “\*\*\*”, Tiranë.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi që deri në datën 9.9.2008 të kursejë nga pagat e vitit 2008 shumën 527,864 lekë<sup>8</sup>, e cila është e mjaftueshme për të mbuluar shumën që nevojitet për të plotësuar pagesën totale prej 1,116,000 lekësh.
- iii. Nuk u konstatua situatë konflikti interesi e subjektit të rivlerësimit me shtetasin L.K. dhe shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.
- iv. Nga dokumentacioni i përcjellë nga ASHK-ja dhe nga notere E.T., u konfirmua historiku i pronësisë së apartamentit me sip. 137.4 m<sup>2</sup>, nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. te shtetasi L.K. me kontratë shkëmbimi dhe, më pas, me kontratën e shitjes te blerësi Valbon Çekrezi.
- v. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë të pagimit të çmimit në DIPP-në e vitit 2008 dhe në deklaramen *Vetting*, ballafaquar kjo me deklaramin në kontratën e shitblerjes së apartamentit nr. \*\*\*, datë 31.7.2008.

Trupi gjykues, përveç fakteve të sipërcituara, vlerëson se në këtë çështje objekt vlerësimi marrin një vlerë provuese edhe faktet e qenësishme të lidhura me pagesat për këtë pasuri me transferta

---

<sup>8</sup>Të ardhurat nga pagat (986,615 lekë) - shpenzime jetike për 8 muaj (182,160 lekë) - pagesë kredie (57,758 lekë) - shpenzime udhëtimi (146,667 lekë) 128,333 lekë = 527,864 lekë mundësia për kursim më deri 9.9.2008.



bankare e në përputhje me dokumentacionin bankar mbi qëllimin e kërkimit të kësaj kredie dhe specifikisht i) provohet fakti që shuma prej 30,000 Euro ka kaluar përmes llogarisë bankare të subjektit në datë 11.7.2008, të cilat rezultuan me burime të ligjshme; ii) provohet me dokumentacion se shuma e kredisë prej 50.000 Euro është disbursuar në llogarinë bankare të subjektit që në datë 9.9.2008; iii) konfirmohet me transksion bankar që shuma prej 80,000 Euro ka kaluar nga llogaria e subjektit të rivlerësimit në llogarinë bankare të shitësit; iii) nga dokumentacioni bankar, kontrata e kredisë, provohet fakti që qëllimi dhe destinacioni i saj ka qënë për blerjen e kësaj pasurie; iv) provohet fakti që po kjo pasuri është vendosur kolateral për garancinë e kësaj kredie;

Mbi faktet e dala sa më sipër arsyetuar trupi gjykues vlerëson, se deklarimi i pasaktë i subjektit në kontratën e shitblerjes së apartamentit nr. \*\*\* rep., e nr. \*\*\* kol., datë 31.7.2008, në raport me tërësinë e fakteve të dala për këtë çështje, nuk identifikon shkaqe për deklarimin të rremë apo fshehje të burimeve financiare e për rrjedhojë kjo pasaktësi në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, e mbetur e vetme, nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkakut që të passjellë si pasojë aplikimin e pikës 3/5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, që mund të çojë deri në aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit të subjektit nga detyra.

### **Analizë financiare – për burimin e krijimit të pasurisë apartament me sip. 137.4 m<sup>2</sup>**

**1.13 Burimi 1:** vlera 3,384,280 lekë përfituar nga shitja e apartamentit me sip. 73 m<sup>2</sup> me kontratën nr. \*\*\*, datë 11.7.2007, ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Elbasan (apartament i blerë në vlerën 556,265 lekë me kontratën nr. \*\*\*, nga EKB-ja Elbasan, në vitin 2001, vlerë e cila përbën diferencën mes vlerës së këtij apartamenti dhe vlerës së apartamentit të përfituar nga privatizimi i banesave shtetërore me kontratën e privatizimit, datë 30.8.1993, në lagjen “\*\*\*\*”, Elbasan).

**1.13.1** Në DPV-në e vitit 2003, subjekti ka deklaruar: *“Apartament banimi 2+1 me sip. 73 m<sup>2</sup> me adresë rr. ‘\*\*\*\*’, Elbasan, privatizuar nga EKB-ja Elbasan me vlerë 1.035 milion lekë me pjesë 100% me burim krijimi: të ardhura nga paga ime dhe nënës time. Në vlerën e apartamentit është përfshirë dhe vlefata e apartamentit që kemi pasur si të pastrehë dhe e kemi dorëzuar”.*

Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar: *“Shitur apartamenti me sip. 73 m<sup>2</sup> me adresë lagjja ‘\*\*\*\*’, Elbasan në shumën 3,384,280 lekë”.*

**1.13.2** Subjekti ka depozituar kontratën e privatizimit të banesës, datë 3.8.1993, lidhur ndërmjet NK Banesa dhe qiramarrësit H.Ll. për privatizimin e banesës nr. \*\*\*, rr. “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, k. \*\*\*, 1+1, Elbasan, si dhe kontratë shitjeje banese, datë 20.8.1993<sup>9</sup>, lidhur me shitës NK Banesa dhe blerës H.Ll. për apartamentin 1+1 nr. \*\*\*, p. \*\*\*, lagjja “\*\*\*\*”, kundrejt vlerës 5,280 lekë.

**1.13.3** Fillimisht, në datën 3.8.1993, është lidhur kontrata e privatizimit të banesës lidhur ndërmjet NK Banesa Elbasan dhe qiramarrësit H.Ll. për privatizimin e banesës nr. \*\*\*, p. \*\*\* (1+1), shk. \*\*\*, k. \*\*\*, rr. “\*\*\*\*”, me pagesë të menjëhershme në shumën 3,680 lekë.

Me kontratën e shitblerjes, datë 2.10.1997, shitësit Valbon Çekrezi dhe H.Ll. i shesin blerësit EKB Elbasan, apartamentin me sip. 49.16 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, p. \*\*\* (1+1), kundrejt çmimit 479,612 lekë.

---

<sup>9</sup>Kontratë shitje e banesës nr. \*\*\*, datë 20.8.1993.

Më pas, me kontratë shitblerjeje apartamenti me pagesë të menjëhershme, datë 19.2.2001<sup>10</sup>, me shitës EKB-në Elbasan dhe blerës Valbon Çekrezi, i shitet apartamenti me sip. 73 m<sup>2</sup>, ap. \*\*\*, lagjja “\*\*\*\*”, Elbasan, me vlerën 1,035,877 lekë. Në pikën (b) të kontratës përcaktohet se: “*Meqë blerësi dorëzon apartament 479,612 lekë, detyrimi financiar referuar kostos së EKB-së është 556,265 lekë dhe pas zbritjes për pagesë të menjëhershme është paguar shuma 420,254 lekë*” (pas aplikimit të uljes, shitësit i mbetet të shlyejë 317,359 lekë).

**1.13.4** Komisioni hetoi në lidhje me mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe nënës së tij për të paguar diferencën e çmimit për apartamentin me sip. 73 m<sup>2</sup>, nga ku rezultoi se ata kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme financiare për të paguar diferencën cmimit.

Me kontratën e datës 11.7.2008<sup>11</sup> shitësit H.Ll. dhe Valbon Çekrezi ia shesin apartamentin me sip. 73 m<sup>2</sup>, ap. \*\*\*, k. \*\*\*, shk. \*\*\*, lagjja “\*\*\*\*”, Elbasan, shtetasit G.Ll. me çmimin 3,384,280 lekë.

**1.13.5** Komisioni ka kërkuar nga subjekti të shpjegojë se ku ka banuar për periudhën 2.10.1997 – 19.2.2001, kur i ka kthyer EKB-së apartamentin me sip. 53.73 m<sup>2</sup>, deri kur ka blerë prej saj apartamentin me sip. 73 m<sup>2</sup>.

Subjekti ka shpjeguar se gjatë kësaj periudhe ka banuar po në apartamentin me sip. 73 m<sup>2</sup>, në lagjen “\*\*\*\*”, Elbasan, pasi pas pagesës fillestare prej 30,000 lekësh, të bërë më 30.6.1996, EKB-ja Elbasan e ka autorizuar subjektin ta ketë apartamentin në përdorim. Më pas, në datën 9.2.2000 është paguar shuma 21,395 lekë dhe më 19.2.2001 është realizuar blerja përfundimtare e tij.

Subjekti ka depozituar si provë kontratën e shitjes me kusht të datës 15.2.2000<sup>12</sup>, ku pasqyrohen pagesat e sipërcituara.

**Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me deklarin dhe mënyrën e përfitimit të apartamenteve, përkatësisht me sip. 53.72 m<sup>2</sup> dhe 73 m<sup>2</sup>.**

**1.14 Burimi 2: vlera 50,000 euro marrë kredi nga “Alpha Bank” me kontratën e kredisë së datës 29.8.2008.**

Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar: “*Kredi e marrë tek ‘Alpha Bank’ në gusht të vitit 2008 në shumën 50,000 euro për blerje shtëpie*”.

**1.14.1** Subjekti ka depozituar: (i) kontratë kredie shumëqëllimore, datë 29.8.2008<sup>13</sup>, lidhur mes “Alpha Bank” dhe kredimarrësit Valbon Çekrezi, për marrjen e kredisë në shumën 50,820 euro me afat 25 vjet; (ii) kontratë hipoteke, datë 29.8.2008<sup>14</sup>, lidhur mes “Alpha Bank” dhe z. Valbon Çekrezi, për vënien në hipoteke në favor të bankës apartamentin me sip. 137.4 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, k. \*\*\*.

**Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me burimin 2, kredi e marrë në “Alpha Bank”.**

**1.15 Burimi 3: diferenca nga të ardhurat ndër vite.**

---

<sup>10</sup>Kontratë shitje apartamenti me pagesë të menjëhershme nr. \*\*\*, datë 13.2.2001.

<sup>11</sup>Kontratë shitje nr. \*\*\*, datë 11.7.2008.

<sup>12</sup> Kontratë shitje me kusht nr. \*\*\*, datë 15.2.2000

<sup>13</sup> Kontratë për kufi kredie shumëqëllimor nr. \*\*\*, datë 29.8.2008.

<sup>14</sup> Kontratë hipoteke nr. \*\*\*

Subjekti ka deklaruar kursime nga të ardhurat, ndër vite, si vijon:

DIPP/2004	Kursime vjetore 400,000 lekë (1.1.2004 – 31.12.2004)
DIPP/2005	Kursime vjetore 300,000 lekë
DIPP/2006	Kursime vjetore 300,000 lekë
DIPP/2007	Kursime vjetore 350,000 lekë
DIPP/2008	Subjekti nuk ka bërë deklaram në lidhje me kursimet

Subjekti ka deklaruar kursimet vjetore të krijuara për secilin vit kalendarik. Të ardhurat e krijuara në formën e kursimeve, ndër vite, deri në vitin 2007 janë në shumën 1,350,000 lekë.

Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, për periudhën 2004 – 2007, e cila rezulton me balanca pozitive, duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve, krijimin e pasurisë dhe kursimeve.

**Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me burimin 3, të ardhurat, ndër vite, në formën e kursimeve, të cilat deri në vitin 2007 janë në shumën 1,350,000 lekë.**

**2. Automjet tip “Mercedes-Benz C220”, viti i prodhimit 2007, blerë me kontratën nr. \*\*\*, datë 17.12.2015, me çmimin 9,700 euro, me pjesë takuese 100%.**

**Burimi i krijimit:** (a) vlera 9,000 euro përfituar nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz C220”, me kontratën nr. \*\*\*, datë 6.4.2013 (automjeti i shitur u ble me të ardhurat ndër vite); (b) diferenca me të ardhurat.

### **Hetimit adminsitrativ i kryer nga Komisioni**

**2.1** Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti deklaron: *“Blerë automjet me kontratën, datë 17.12.2015, në shumën 9,700 euro”*.

**2.2** Subjekti ka depozituar kontratën e shitjeblerjes së automjetit tip “Mercedes Benz 204, C220 CDI”, me targa \*\*\*, datë 17.12.2015<sup>15</sup>, me shitës G.N. dhe blerës Valbon Çekrezi, për shumën 9,700 euro.

**2.3** DPSHTRr-ja<sup>16</sup> ka përcjellë dokumentacionin nga ku rezulton se automjeti “Mercedes-Benz”, prodhim i vitit 2007, datë 24.1.2012, nga shoqëria gjermane “\*\*\*” i është shitur shtetasit G.N. me çmimin 9,700 euro. Nga dokumenti doganor, datë 6.2.2013, rezulton se shtetasi G.N. ka paguar taksën doganore në shumën 275,111 lekë (konvertuar me kursin ditor 139,58 lekë/euro = 1,970 euro). Në total mjeti ka kushtuar 9,700 euro+1970 euro= 11,670 euro. Pas 3 vjetësh ia ka shitur automjetin subjektit të rivlerësimit për çmimin 9,700 euro.

**2.4** Në pyetësin nr. 2, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime nëse ka njohje me shtetasin G.N. Në përgjigjen e tij, subjekti ka deklaruar se: *“Shtetasin G.N. e njoh që prej vitit 2004 dhe me këtë shtetas kam lidhje shoqërore, që vijojnë që prej njohjes tonë dhe deri më sot”*.

**2.5** Komisioni ka hetuar edhe mbi ndonjë situatë të mundshme të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit me shtetasin G.N., duke kryer korrespondencën përkatëse me Gjykatën e Apelit

<sup>15</sup>Kontratë shitje nr. \*\*\*, datë 17.12.2015.

<sup>16</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 19.6.2019, e DPSHTRr-së.

Durrës dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan<sup>17</sup> dhe nga hetimi i kryer nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.

**Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me deklarin e mjetit nga subjekti dhe dokumentacionin përkatës.**

**Analizë financiare – burimit të krijimit të shumës 9,700 euro**

**2.6 Burimi 1: vlera 9,000 euro përfituar nga shitja e automjetit tip “Mercedes Benz C220”, me kontratën e datës 6.4.2013<sup>18</sup> (automjeti i shitur u ble me të ardhurat ndër vite).**

Në DIPP-në e vitit 2007, subjekti deklaroi: “Blerë autoveturë, kontrata datë 25.10.2007 nr. \*\*\*. Vlera: 500,000 lekë.” Në DIPP-në e 2013, subjekti deklaroi: “Kam shitur makinën ‘Benz-Mercedes’, me kontratën nr. \*\*\*, datë 6.4.2013, në shumën 9,000 euro”.

Komisioni ka kryer analizën financiare të subjektit të rivlerësimit në momentin e blerjes së automjetit<sup>19</sup> në vitin 2007, në shumën 500,000 lekë.

Nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”.

**2.6.1** Subjekti ka depozituar kontratën e shitblerjes së automjetit tip “Mercedes-Benz C220 D”, me targa \*\*\*, datë 6.4.2013<sup>20</sup>, me shitës Valbon Çekrezi dhe blerës A.Z., me çmimin 9,000 euro.

**2.6.2** DPSHTRr-ja<sup>21</sup> ka konfirmuar se shtetasi Valbon Vullnet Çekrezi ka pasur të regjistruar automjetin me targa \*\*\* (\*\*\*), si dhe ka depozituar dokumentacionin përkatës. Rezulton se automjeti tip “Mercedes-Benz C220 D”, viti 1998, është blerë nga shtetasi E.K. në datën 2.10.2007, në shtetin gjerman me çmimin 3,000 euro. Nga dokumenti doganor i datës 14.10.2004, rezulton se shtetasi E.K. ka paguar taksën doganore për këtë automjet në shumën 284,666 lekë. Duke konvertuar çmimin 3,000 euro me kursin ditor 123,80 lekë/euro = 369,240 lekë vlera e mjetit + 284,660 lekë dogana = 653,900 lekë vlera totale e mjetit. Në datën 25.10.2007 (pas 11 ditësh), shitësi E.K. ia shet subjektit Valbon Çekrezi me çmimin 500,000 lekë.

Ndërsa, në datën 6.4.2013, pas 6 vjetësh subjekti i rivlerësimit e shet këtë automjet me çmimin 9,000 euro, çmim që nuk përkon me logjikën financiare të shitjes së makinave në tregun e lirë referuar vitit të prodhimit të tij 1998.

**2.6.3** Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar: “Shtesë gjendje cash në banesë për vitin 2013, të ardhura nga pagat 150,000 lekë”. Subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2013 kursime nga shitja e automjetit.

**2.6.4** Në pyetësin nr. 3, subjekti ka dhënë shpjegime në lidhje me deklarin e kursimeve cash, ndër vite, ku ka deklaruar se në vitin 2013 ka pasur si kursime cash edhe shumën prej 9,000 euro

<sup>17</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.2.2021, nga Gjykata e Apelit Durrës.

<sup>18</sup>Kontratë nr. \*\*\*, datë 6.4.2013.

<sup>19</sup>Në datën 25.10.2007 subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mundësi financiare për blerjen e automejtit, pasi ka pasur në total 1,013,476 lekë të ardhura (907,059 lekë të ardhura nga paga e tij dhe 106,417 lekë të ardhura nga pensioni nënës), për të kryer shpenzime në vlerën 392,700 lekë (227,700 lekë shpenzime jetike dhe 165,000 leke shpenzime udhëtimi) dhe krijuar pasuri në vlerën 546,229 lekë (blerje e mjetit në shumën 500,000 lekë dhe ndryshim likuiditeti në shumën 46,229 lekë).

<sup>20</sup>Kontratë shitblerje nr. \*\*\*, datë 6.4.2013.

<sup>21</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.10.2020, e DPSHTRr-së.

nga shitja e automjetit në vitin 2013, të cilën e ka përdorur në vitin 2015 për blerjen e automjetit tjetër.

**2.6.5** Në pyetësi nr. 2, subjektit i është kërkuar të provojë me dokumentacion ligjor pagesën e tatimit për diferencën e çmimit.

Subjekti ka shpjeguar se: “[...] Për faktin e veprimtarisë time të kufizuar me zyrën e tatimeve, duke qenë se për të vetmet të ardhura që unë kam pasur, paga dhe pagesa për mësimdhënien, tatimet mbaheshin nga punëdhënësi në kohën e kryerjes së pagesave, kjo ka qenë një mungesë vëmendje nga ana ime, por jo shmangie nga detyrimet. [...]Me marrjen dijani nëpërmjet këtij pyetësi për ekzistencën e një detyrimi të tillë, duke e konsideruar përgjegjësi timen, kam kryer pagesën e detyrimit përkatës”.

Subjekti ka depozituar: (i) formularin “Urdhërpagesë, tatimi mbi të ardhurat individuale” e prodhuar nga sistemi elektronik i tatimeve më 19.11.2020 për periudhën janar – dhjetor 2013, detyrim principal në shumën 75,919 lekë; (ii) dokumenti i pagesës bankare “Transferte në llogari”, datë 20.11.2020, e lëshuar nga “Raiffeisen Bank”, në shumën 75,919 lekë.

**2.6.6** Subjekti, i pyetur nga Komisioni nëse ka njohje me shtetasin E.K., ka deklaruar se: “Me shtetasin E.K. nuk kam asnjë njohje dhe me sa më kujtohet nuk kam pasur ndonjëherë kontakt me të, përveçse në kohën e blerjes së këtij automjeti”.

**2.6.7** Komisioni ka hetuar për situata konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me shtetasit E.K. dhe A.Z., duke kryer korrespondencën përkatëse me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Gjykatën e Apelit Durrës<sup>22</sup> dhe nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.

**2.6.8** Komisioni gjatë hetimit administrativ ka konstatuar se: (i) shitja e automjetit me targa \*\*\* (blerë në vitin 2007 në vlerën 500,000 lekë), pas 6 vjetësh nga subjekti i rivlerësimit me çmimin 9,000 euro, dukshëm më i lartë se çmimi i blerjes, është çmim që nuk përkon me logjikën financiare të shitjes së makinave në tregun e lirë referuar vitit të prodhimit viti 1998 dhe amortizimit të tij, ndër vite; (ii) subjekti i rivlerësimit ka bërë pagesën e tatimit për diferencën e çmimit të blerjes me atë të shitjes (për automjetin e shitur në vlerën 9,000 euro) me vonesë, pas depozitimit të deklaratës *Vetting*, në datën 20.11.2020 pas dërgimit të pyetësit nr. 2.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**2.6.9** Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, në prapësimet e tij dhe në shpjegimet e dhëna në seancën dëgjimore, ka shpjeguar se: “[...] unë e përdorja mjetin për të udhëtuar për në punë, së pari siguria dhe, së dyti cilësia e të udhëtuarit, më kanë bërë që gjatë viteve të isha shumë i kujdesshëm në lidhje me mirëmbajtjen e tij, duke i bërë kontrollet periodike të shpeshta, si dhe të gjitha riparimet e nevojshme dhe disa përmirësime. Përmirësimet kanë konsistuar në ndërrimin e disqeve, lyerjen e makinës, si dhe me pjesët inxhinierike të mjetit, etj. Në kohën që është shitur, mjeti ka qenë në gjendje teknike e fizike shumë të mirë.[...] kam kërkuar tek i njëjti noter që ka përpiluar kontratën e shitjes (z. I.R.), për kontrata shitje të asaj periudhe për mjete të të njëjtit lloj. Nga ana e noterit më është vënë në dispozicion kontrata e shitjes nr. \*\*\*, datë 1.1.2013, sipas të cilës, çmimi i shitjes ka qenë 600,000 lekë.

---

<sup>22</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.11.2020, e Gjykatës së Apelit Durrës; dhe shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.11.2020, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

*Dua të bëj prezent faktin se vlera në tregun e lirë për atë tip mjeti më rezulton të mos ketë pësuar ulje, por përkundrazi. Kjo mbase nga cilësia e mjeteve të atij vit prodhimi dhe kërkesat qoftë në tregun e brendshëm, ashtu dhe atë ndërkombëtar.*

*Mund t'ju them se nga një kërkim që kam bërë në internet në platformën online (<https://mobile.de/>), platforma për kërkimin, blerjen dhe shitjen e makinave të përdorura e të reja, edhe sot çmimi për këtë tip mjeti në Gjermani shkon rreth 4,000 euro. Nëse këtu do të përfshiheshin edhe shpenzimet për mbërritjen e tij në Shqipëri, detyrimet tatimore të importit dhe detyrimet për regjistrimin e mjetit, çmimi do të shkonte rreth 6,000 euro.[...] Ndaj si e ardhur nga shitja pretendoj se duhet të konsiderohet pikërisht ajo e pasqyruar në kontratën e shitjes, duke vlerësuar si të saktë deklarin tim në këtë drejtim.*

*Lidhur me konstatimin se: 'pagesa e tatimit për diferencën e çmimit të blerjes me atë të shitjes (për mjetin e shitur në vlerën 9,000 euro) është bërë me vonesë, pas depozitimit të deklaratës Vetting, datë 20.11.2020', dua të sqaroj se, siç kam shpjeguar edhe në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, mungesa e pagesës së një detyrimi të tillë ka ardhur në kushtet kur për pagimin e një detyrimi të tillë nuk kam qenë i njohur, bile as noteri nuk ma ka bërë të ditur që kam këtë detyrim, ndërkohë që ka qenë hera e parë për mua që kryeja një veprim të kësaj natyre. Nisur nga kjo, marrë shkas nga pyetja e parashtruar në pyetësor, çka linte të kuptohej se unë mbartja detyrimin për pagimin e tatimit mbi të ardhurat, pavarësisht se ligji nuk është krejt i qartë në këtë drejtim, si shenjë vullnetit për të qenë korrekt në raport me detyrimet ndaj shtetit, i jam drejtuar menjëherë zyrës së tatimeve (sistemit online) dhe kam bërë pagesën e detyrimit dhe çdo detyrim që buronte nga kjo vonesë”.*

## **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

**2.6.10** Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion ligjor (fatura, pagesa etj.), që të vërtetojë kryerjen e shpenzimeve për mirëmbajtjen, riparimet e nevojshme, përmirësime, ndërrim disqesh, lyerje ndërrim pjesë inxhinierike etj., që do të vërtetonin rritjen e vlerës së automjetit dhe justifikimin e çmimit të shitjes për 9,000 euro.

Për sa i përket pagimit të tatimit mbi të ardhurën për diferencën e çmimit të blerjes me atë të shitjes, Komisioni nuk e mori në konsideratë këtë pagesë me arsyetimin se kjo është bërë për efekt të procesit të rivlerësimit *Vetting* konsoliduar kjo edhe nga praktika e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit<sup>23</sup>.

Komisioni, në analizën financiare për subjektin e rivlerësimit, ka marrë në konsideratë si të ardhura nga shitja e automjetit në vitin 2013, vetëm vlerën prej 500,000 lekësh, që i korrespondon çmimit të blerjes dhe jo vlerën 9,000 euro që i korrespondon çmimit të shitjes së këtij automjeti.

## **2.7 Burimi 2: diferenca me të ardhurat**

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi të dytë për blerjen e automjetit, të ardhurat.

Referuar analizës financiare për vitin 2015 subjekti i rivlerësimit rezulton me balancë financiare negative prej – 562,653 lekw.

Në përfundim të hetimit në lidhje me këtë pasuri, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën – 562,653 lekë, për blerjen e

<sup>23</sup> Vendim Nr. 8/2019 (JR), datë 16.04.2019, i Kolegjit për subjektin e rivlerësimit A. N., pika 63 paragrafi III.

automjetit tip “Mercedes – Benz”, viti i prodhimit 2007, me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 6.4.2013.

**Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me burimin e dytë “diferenca me të ardhurat”.**

**3. Llogari rrjedhëse në euro tek “Alpha Bank”, për pagesën e kredisë me balancë aktuale 50,48 euro me pjesë takuese 100%.**

“Alpha Bank”<sup>24</sup> konfirmon llogarinë rrjedhëse në emër të subjektit të rivlerësimit me gjendje llogarie në shumën 40.48 euro, në datën 25.1.2017.

Në këtë llogari bankare është disbursuar kredia e marrë në datën 3.9.2008, në shumën 50,000 euro, e përdorur si burim për blerjen e apartamentit dhe transferuar në llogarinë e shtetasit L.K.

**Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me këtë llogari bankare të subjektit.**

**4. Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, me balancë aktuale në vlerën 51,260 lekë**

“Raiffeisen Bank”<sup>25</sup> konfirmon llogarinë e pagës në emër të subjektit të rivlerësimit me gjendje në datën e dorëzimit të deklaratës *Vetting* më 25.1.2017, në shumën 51,260 lekë.

**Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me llogarinë e pagës në “Raiffeisen Bank”.**

**5. Likuiditet *cash* në banesë në shumën 1,400,000 lekë, me pjesë takuese 100%, me burim krijimi të ardhurat ndër vite.**

**5.1** Subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2016, ka deklaruar: “*Shlyer huaja e marrë tezes (Sh.Ll.) në shumën 400,000 lekë, me burim nga kursimet. Likuiditete cash në banesë, gjendja në datën 31.12.2016 ka qenë në shumën 1,400,000 lekë*”.

**5.2** Në pyetësin nr. 3, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime në lidhje me deklaratimet e gjendjes *cash* ndër vite<sup>26</sup>.

**5.3** Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti nuk ka bërë deklaram në lidhje me gjendjen *cash*, por në deklaratën *Vetting* ka deklaruar gjendjen *cash* të krijuar me kursimet, ndër vite, si burim për krijimin e apartamentit në vitin 2008. Subjekti ka shpjeguar se ka përdorur nga kursimet shumën prej 1,000,000 lekësh për apartamentin dhe mobilimin e tij. Nga analiza financiare e kryer në

---

<sup>24</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.6.2019, nga “Alpha Bank”.

<sup>25</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.6.2019, nga “Raiffeisen Bank”.

<sup>26</sup> Gjendja *cash* në datën 31 dhjetor të çdo viti (akumuluar), përkatësisht: në vitin 2004 (subjekti deklaron në DIPP “Kursime vjetore 400,000 lekë për periudhën 1.1.2004 – 31.12.2004”) në shumën 400,000 lekë; në vitin 2005 (subjekti deklaron në DIPP “Kursime vjetore 300,000 lekë”) në shumën 700,000 lekë; në vitin 2006 (subjekti deklaron “Kursime vjetore 300,000 lekë”) në shumën 1,000,000 lekë; në vitin 2007 (subjekti deklaron në DIPP “Kursime vjetore 350,000 lekë”) në shumën 1,350.000 lekë; në vitin 2008 (subjekti shpjegon në pyetësor se ka përdorur nga gjendja *cash* e akumuluar, shumën 1,000,000 lekë, për arredim etj.) në shumën 350,000 lekë; në vitin 2009 (subjekti deklaron në DIPP “Shtesë gjendje *cash* në banesë për vitin 2009, të ardhura nga pagat 100,000 lekë”) në shumën 450,000 lekë; në vitin 2010 (subjekti deklaron në DIPP “Shtesë gjendje *cash* në banesë për vitin 2010, të ardhura nga pagat 100,000 lekë”) në shumën 550,000 lekë; në vitin 2011 (subjekti deklaron në DIPP “Shtesë gjendje *cash* në banesë për vitin 2011, të ardhura nga pagat 100,000 lekë”) në shumën 650.000 lekë; në vitin 2012 (subjekti deklaron në DIPP “Shtesë gjendje *cash* në banesë për vitin 2012, të ardhura nga pagat 150,000 lekë”) në shumën 800,000 lekë; në vitin 2013 (subjekti deklaron në DIPP “Shtesë gjendje *cash* në banesë për vitin 2013, të ardhura nga pagat 150,000 lekë” dhe shpjegon se ka shtuar kursimet edhe me 9,000 euro nga shitja e mjetit) në shumën 950,000 lekë + 9,000 euro; në vitin 2014 (subjekti deklaron në DIPP “Shtuar gjendje *cash* në banesë, 250,000 lekë. Kursyer prej të ardhurave nga paga *neto* për vitin 2014”) shumën 1,200.000 lekë + 9,000 euro; në vitin 2015 (subjekti shpjegon në pyetësor se ka përdorur shumën 9,000 euro të shitjes së automjetit në vitin 2013, për blerjen e automjetit në vitin 2015) në shumën 1,200,000 lekë; në vitin 2016 (subjekti deklaron në DIPP “Likuiditete *cash* në banesë, gjendja në datë 31.12.2016 ka qenë 1,400,000 lekë”) në shumën 1,400,000 lekë.

momentin e pagesës së apartamentit, duket se subjekti ka përdorur të gjithë shumën e kursimeve prej 1,350,000 lekësh dhe deri në fund të vitit ka krijuar kursime *cash* në shumën 350,000 lekë, nga ku për vitin 2008 rezulton me një balancë financiare negative në shumën 14,285 lekë.

Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar shitjen e automjetit në vlerën 9,000 euro si ndryshim në pasurinë e tij. Në DIPP-në e 2015, subjekti ka deklaruar shtimin e pasurisë për blerjen e automjetit të ri për të cilin nuk ka deklaruar burim krijimi, por në deklaratën *Vetting* ka deklaruar se si burim kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e automjetit në vitin 2013.

**5.4** Komisioni gjatë hetimit administrativ ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2008 nuk ka deklaruar shtesa apo pakësime të gjendjes *cash*.

**5.4.1** Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e dhëna gjatë hetimit dhe në shpjegimet e dhëna në seancën dëgjimore, ka shpjeguar se: “[...] siç mund të konstatohet në të gjitha deklaratimet e mia, ndër vite, sa i përket gjendjes *cash*, kam deklaruar vetëm ato vite kur kam patur shtesa, pra kursime. Për vitin 2008 unë nuk kam pasur shtesë, prandaj nuk kam deklaruar të tilla. Deri në fund të vitit 2007, gjendja e akumuluar *cash* ka qenë në shumën 1,350,000 lekë, një pjesë të të cilave e kam përdorur gjatë vitit 2008, bashkë me kursimet e këtij viti. Vetë gjendja e mbetur (pas akumulimit dhe harxhimit) deri në vitin 2016 dhe *Vetting* prej 1.400.000 lekësh, konfirmon deklaratimet e mia vit pas viti”.

#### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

**5.5** Komisioni vëren se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me mosdeklarimin e gjendjes *cash* për vitin 2008, pasi sikundër provohet nga deklaratimet periodike subjekti deklaroi vetëm shtesa të gjendjes *cash* dhe në asnjë vit nuk deklaroi pakësim të tij. Kronologjia e deklaratimeve të gjendjes *cash* në deklaratimet periodike vjetore përputhet me deklarimin përfundimtar të gjendjes *cash* në shumën prej 1,400,000 lekësh në deklaratën *Vetting*.

**Komisioni vlerëson se mosdeklarimi i pakësimit të gjendjes *cash* në vitin 2008, për arsye të blerjes së apartamentit, mbetet një pasaktësi në deklarim me peshë minimale, që nuk sjell si pasojë aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, që mund të çojë deri në aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit të subjektit nga detyra.**

### **KONSTATIME TË TJERA**

**6. Hua në shumën 400,000 lekë marrë në vitin 2008 nga shtetasja Sh.Ll. (Sh.), teza e subjektit.**

**6.1** Në DIPP-në e vitit 2008, në rubrikën të dhëna konfidenciale, subjekti ka deklaruar: “*Marrë hua nga shtetasja Sh.A.Ll. (Sh.), në shumën 400,000 lekë (motra e nënës), pa kamatë dhe pa përcaktuar datën e shlyerjes. Për shkak të marrëdhënies së posaçme është bërë verbale*”.

Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar: “*Shlyer huaja e marrë tezes (Sh.Ll.) në shumën 400,000 lekë me burim nga kursimet*”.

**6.2** Subjektit, gjatë hetimit administrativ, i është kërkuar të provojë me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të krijimit të shumës 400,000 lekë dhënë hua nga teza e tij dhe të përcaktojë destinacionin e përdorimit të kësaj huaje.

Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e tij, ka deklaruar se: “*Destinacioni i përdorimit të kësaj huaje ka qenë arredimi i apartamentit në pronësinë time*” .



Subjekti rivlerësimi ka depozituar dokumentacion ligjor për të ardhurat nga paga të përfituara nga tezja e tij në periudhën 1994 – 2013<sup>27</sup>.

**6.3** Komisioni ka kryer analizën financiare<sup>28</sup> për mundësinë e dhënies së huas dhe rezultoi se tezja e subjektit të rivlerësimit ka pasur mundësi që me të ardhura të ligjshme t'i japë hua subjektit në shumën 400,000 lekë.

**Komisioni, pasi mori në analizë shpjegimet dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, arriti në përfundimin se personi tjetër i lidhur me të/tezja e tij, shtetasja Sh.Ll. (Sh.), ka pasur burime të ligjshme financiare për dhënien e huas në shumën 400,000 lekë.**

## **7. Analiza financiare**

Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni përgatiti analizën financiare mbështetur në të dhëna në deklaratimet periodike vjetore në ILDKPKI, në deklaratën *Vetting*, në informacionet e ardhura nga institucionet përkatëse dhe nga deklaratimet e subjektit. Z. Valbon Çekrezi ka qenë subjekt deklarimi pa ndërprerje që prej vitit 2003.

### **7.1 Metodologjia e kryerjes së analizës financiare**

Për efekt të pasqyrit të metodologjisë së ndjekur, Komisioni, në këtë analizë financiare, është bazuar në deklaratat e interesave pasurore private/vjetore, deklaratën *Vetting*, pyetësorët me përgjigjet e subjektit, si dhe në korrespondencën e Komisionit me institucionet publike dhe jopublike. Kjo metodologji shërben për të vlerësuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të realizuar kursimet, pasuritë e deklaruara, për të paguar shpenzimet, si dhe evidentimin e rasteve kur subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme pasuritë e krijuara (pasuri të luajtshme, të paluajtshme, likuiditete) dhe shpenzimet e kryera.

**7.2** Analiza financiare e subjektit, për periudhën e hetuar, bazohet në të ardhurat e ligjshme sipas vërtetimeve për të ardhurat nga pagat dhe honorarët në vlerë *neto* lëshuar nga institucionet publike për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të<sup>29</sup>, që janë deklaruar dhe janë paguar detyrimet tatimore në zbatim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

**7.3** Për të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme<sup>30</sup> është marrë në analizë vlera sipas kontratës së shitjes.

**7.4** Për të ardhurat nga shitja e pasurive të luajtshme (automjete)<sup>31</sup> janë marrë në analizë vlerat sipas kontratave dhe nuk është marrë në analizë, si të ardhura të ligjshme, pjesa e fitimit (çmim shitje-çmim blerje) e realizuar nga shitja e mjeteve, pasi rezultoi se detyrimi tatimor për pagesën

<sup>27</sup>Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 17.11.2020, i Drejtorisë Rajonale të ISSH-së Elbasan.

<sup>28</sup>Personi tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit, tezja e tij, ka rezultuar me mundësi financiare për dhënien e huas, pasi për vitet 2006 – 2007 ka pasur në total shumën prej 818,781 lekësh të ardhura me të cilat ka mbuluar shpenzimet jetike në shumën 246,177 lekë dhe ka dhënë hua shumën 400,000 lekë.

<sup>29</sup>Vërtetimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, datë 1.10.2016, për periudhën 16.7.1992 – 31.3.2001; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 28.10.2016, nga Universiteti “\*\*\*”; vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë 16.1.2017, i Gjykatës së Apelit Durrës, për periudhën 2001– 2008; vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë 16.1.2017, i Gjykatës së Apelit Durrës, për periudhën 2008 – 2016; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 17.11.2020, i Drejtorisë Rajonale të ISSH-së Elbasan.

<sup>30</sup>Kontratë shitje nr. \*\*\* , datë 11.7.2008, në shumën 3,384,280 lekë.

<sup>31</sup>Kontratë blerje nr. \*\*\* , datë 25.10.2007; kontratë shitje nr. \*\*\* , datë 6.4.2013.

e tatimit në burim është përmbushur pas plotësimit të deklaratës *Vetting*, kjo në harmoni me standardin e ndjekur nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit në vendimin nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019. Vlera e llogaritur, si e ardhur e përfituar në shitje, është shuma deri në nivelin e çmimit të blerjes sipas kontratave.

**7.5** Në rubrikën e detyrimeve janë pasqyruar kredia e marrë në “Alpha Bank”<sup>32</sup> në shumën 50,000 euro dhe huaja e marrë nga znj. Sh.Sh. në shumën 400,000 lekë, sipas DPV-së së vitit 2008, për të cilën është provuar burimi i ligjshëm. Lidhur me shpenzimet e deklaruara u verifikuan dhe u krahasuan përputhshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurore private/vjetore, në deklaratën *Vetting*, si dhe aktet e tjera në dosjen e Komisionit. Për analizimin e shpenzimeve u morën në konsideratë sa më poshtë:

**7.6** Shpenzimet e jetesës u bazuan në shpenzimet e përcaktuara në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së drejtuar Komisionit. Shpenzimet jetike, për periudhën 2003 – 2011, janë llogaritur për familje me 2 anëtarë (subjekti dhe nëna), ndërsa për periudhën 2012 – 2016 janë llogaritur me 1 anëtar.

**7.7** Shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit u analizuan bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, konkretisht lëvizjet hyrje-dalje nëpërmjet sistemit *TIMS* të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve, si dhe u krahasuan me deklaratimet e subjektit të dhëna në pyetësorë. Për llogaritjen e shpenzimeve i është referuar deklarimeve të subjektit dhe standardit të vendosur nga Kolegji në lidhje me çmimet e biletave dhe shpenzimeve për karburant, si dhe shpenzimeve ditore të qëndrimit.

**7.8** Shpenzime udhëtimi banesë-punë janë marrë në analizë vlerat e deklaruara nga subjekti në pyetësorin nr. 2.

**7.9** Shpenzime këst kredie janë marrë në analizë shumat e paguara për pagesën e principalit dhe interesit sipas lëvizjeve të llogarisë bankare.

**7.10** Shpenzimet e mobilimit janë marrë në analizë sipas deklaratimit të subjektit në pyetësorë.

**7.11** Ndryshimi në likuiditete (*cash* dhe bankë) përfaqëson diferencën e gjendjes së likuiditeteve në fund të vitit me gjendjen e likuiditeteve në fillim të vitit.

### Tabela e ndryshimit të likuiditeteve

Përshkrimi	Para 2003	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Likuiditete cash	1 777 880	0	400 000	700 000	1 000 000	1 350 000	350 000	450 000	550 000	650 000	800 000	950 000	1 200 000	1 200 000	1 400 000
Likuiditete bankë	0	0	102 673	20 450	10 191	97 437	24 597	9 217	216 984	204 533	232 556	255 294	284 186	59 231	72 205
Likuiditete Total (cash + bankë)	1 777 880	0	502 673	720 450	1 010 191	1 447 437	374 597	459 217	766 984	854 533	1 032 556	1 205 294	1 484 186	1 259 231	1 472 205
Ndryshim likuiditete (Gjendje likuiditete viti Gjendje likuiditete viti paraardhës)		-1 777 880	502 673	217 777	289 741	437 246	-1 072 840	84 620	307 767	87 549	178 023	172 738	278 892	-224 954	212 973

**7.12** Për analizimin e kursimeve *cash* u morën në konsideratë deklaratimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurore private/vjetore. Deklarimet e subjektit për gjendjen *cash* të akumuluar përputhen me gjendjen e kursimeve *cash* të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*.

**7.13** Në analizë janë marrë në konsideratë gjendja e likuiditeteve në bankë, në fillim dhe në fund të vitit të analizuar, bazuar në të dhënat e pasqyrave të lëvizjeve bankare të individëve.

<sup>32</sup>Kontratë për kufi kredie shumëqëllimor nr. \*\*\*, datë 29.8.2008, lidhur me “Alpha Bank”, për shumën 50,000 euro me afat 25 vjet.

**7.14** Lidhur me pasuritë e paluajtshme<sup>33</sup> dhe pasurinë e luajtshme (automjet)<sup>34</sup> të krijuar është marrë në konsideratë vlera sipas kontratës së shitblerjes.

**7.15** Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se nga analiza e deklaratave të interesave pasurore private/vjetore dhe deklaratës *Vetting*, për periudhën e hetimit 2003 – 2016 të kryer nga Komisioni, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasurinë në shumën 470,508 lekë.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**7.16** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e dhëna prej tij dhe në shpjegimet në seancën dëgjimore, ka shpjeguar se: *“Lidhur me konstatimin tuaj për pamjaftueshmërinë e të ardhurave të ligjshme për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasurinë, në total prej 470,508 lekë, gjatë periudhës 2003 - 2016, pamjaftueshmërinë e të ardhurave që referohet për shumën -14,285 lekë në vitin 2008, për shumën -407,062 lekë në vitin 2013 dhe për shumën -49,161 lekë në vitin 2016, sqaroj sa vijon:*

*Së pari, në tabelën që përfaqëson ndryshimin e likuiditeteve (cash dhe në bankë) në vitet 2013 dhe 2014, më duhet të sqaroj se unë nuk kam patur likuiditete në bankë me gjendje 1,517,184 lekë dhe 1,546,076 lekë, siç pasqyrohet.*

*Duke parë se në vitin 2012 dhe 2015 shuma mbetet vetëm në nivelin e gjendjes së llogarisë së pagës dhe të gjendjes cash në lekë, gjykoj se nga ana e Komisionit gjendjet e sipërcituara duhet të jenë mbledhje e gjendjes së mbetur në llogarinë e pagës dhe gjendjes cash në lekë + konvertimin e gjendjes cash prej 9,000 euro, përfituar nga shitja e automjetit.*

*Në vitin 2013 dhe 2014 nuk kam pasur shpenzime të tjera apo nuk kam shtuar pasuri, përveç shpenzimeve të jetesës e kësteve të kredisë, dhe në vitin 2015, shumën 9,000 euro, e kam përdorur për blerjen e automjetit tjetër.*

*Pikërisht kjo është edhe arsyeja e diferencës së konstatuar në vitin 2013 në shumën prej rreth 407,000 lekë, të mosjustifikimit të pasurive dhe shpenzimeve me burime krijimi, pasi Komisioni ka llogaritur si të ardhur nga shitja e automjetit shumën 500,000 lekë, por në kursimet që kanë ardhur nga shitja e këtij automjeti, është llogaritur konvertimi i shumës 9,000 euro, ose rreth 1,200,000 lekë. Diferencën e çmimit të shitjes së automjetit krahasuar me çmimin e blerjes, e kam trajtuar më lart.*

*Në vlerësimin tim vlera e të ardhurave nga shitja e mjetit nuk ka se si të jetë e ndryshme nga vlera e kursimit pikërisht i këtyre të ardhurave. Kjo vlerë është e njëjtë, pasi vlera e kursimit nuk mund të jetë më e lartë se vlera e të ardhurave. Në aspektin ekonomik, e ardhura nga shitja e automjetit në vitin 2013, është njëherazi edhe kursim, dhe kjo nuk mund të jetë në dy vlera të ndryshme, pasi sa është shitur automjeti, po aq është kursyer, shumë destinacioni i përdorimit të të cilës ka qenë po për blerje automjeti.*

*Konstatoj se rezultati negativ financiar për vitin 2013 vjen pikërisht nga ndryshimi mes vlerës së të ardhurave të llogaritura nga shitja e mjetit (konsideruar 500,000 lekë) me vlerën e llogaritur të kursimit (ku përveç kursimeve vjetore të deklaruara dhe gjendjen në llogari bankare, është*

<sup>33</sup>Kontratë shitje nr. \*\*\*, datë 31.7.2008; kontratë shitje apartamenti banimi me pagesë të menjëhershme nr. \*\*\*, datë 13.2.2001.

<sup>34</sup>Kontratë shitblerje nr. \*\*\*, datë 25.10.2007; kontratë shitblerje nr. \*\*\*, datë 17.12.2015.

*konsideruar edhe vlera e shitjes së mjetit prej 9,000 euro e konvertuar në rreth 1,260,000 lekë). Nëse pranohet se vlera e të ardhurave nga shitja e mjetit është 500,000 lekë, atëherë në të njëjtën vlerë duhet të llogaritet edhe kursimi sa i përket këtij zëri. Dhe po ashtu, nëse vlera e të ardhurave nga shitja e mjetit është 9,000 euro (rreth 1,200,000 lekë), atëherë në të njëjtën vlerë duhet të llogaritet edhe kursimi sa i përket këtij zëri.*

*Duke i qëndruar besnik shifrave të Komisionit në tabelën e faqes 18 të relacionit, nëse pranohen të ardhurat nga shitja e mjetit sipas variantit prej 500,000 lekë, shifër kjo që do të duhet të reflektohet e tillë edhe tek kursimi, atëherë rezultati financiar për vitin 2013 nuk është negativ, por pozitiv në vlerën rreth 352,000 lekë. Ndërkohë kjo gjë, pra konsiderimi i vlerës së të ardhurave nga shitja e mjetit në masën 500,000 lekë, impakton rezultatin financiar për vitin 2015, që do të rezultonte negativ në vlerën rreth 39,000 lekë.*

*Në fakt, unë pretendoj që vlera e të ardhurave nga shitja e mjetit duhet të llogaritet në masën e asaj që kam deklaruar në vijimësi, pra, 9,000 euro, dhe nëse kjo vlerë do të konsiderohej si e ardhur dhe njëherazi si kursim në vitin 2013, atëherë rezultati financiar për këtë vit, do të ishte përsëri i njëjtë, pozitiv prej rreth 352,000 lekë. Nga ana tjetër, duke pranuar këtë vlerë edhe në rubrikën e kursimeve, në rastin e vitit 2015, rezultati financiar i këtij viti do të ishte pozitiv në vlerën rreth 700,000 lekë.*

*Së dyti, diferencat e konstatuara në vitet 2008 dhe 2016 apo dhe në vitin 2015, nëse pranohet sa lart parashtrova, gjykoj se ato janë të papërfillshme ose jo domethënëse në harkun kohor të një viti, për një familje me 2 persona. Ndaj këto diferenca mendoj se duhen të vlerësohen në respektim të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit”.*

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

**7.17** Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij lidhur me vlerën negative të analizës financiare, ka konstatuar se nga Komisioni, në tabelën që përfaqëson ndryshimin e likuiditeteve (*cash* dhe në bankë) në vitet 2013 dhe 2014, janë pasqyruar likuiditete në bankë me gjendje në shumat 1,517,184 lekë dhe 1,546,076 lekë. Subjekti deklaroi se nuk ka pasur gjendje në bankë vlerat e pasqyruara nga Komisioni.

Komisioni vëren se subjekti ka konstatuar drejt pasaktësinë në analizën financiare, pasi gjendja e bankave për vitet 2013 dhe 2014 nuk është në vlerat e pasqyruara në analizën financiare.

Komisioni, pas këtij konstatimi, verifikoi dhe saktësoi gjendjen e llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit për vitet 2013 dhe 2014, nga ku rezultoi gjendja e bankave në vlerat 255,294 lekë dhe 284,186 lekë. Pas këtij saktësimi, ndryshimi i likuiditeteve i pasqyruar në analizën financiare, ndryshon për vitin 2013 nga 1,434,628 lekë në 172,738 lekë dhe për vitin 2015 nga -1,486,844 lekë në -224,954 lekë.

Komisioni, pas shpjegimeve të subjektit, konstaton se qëndron gabimi material i tij në shënimin e shumës 9,000 euro si gjendje bankare për vitet 2013 – 2014.

Komisioni në rezultatet e hetimit nuk e ka konsideruar shumën 9,000 euro të përfituar nga shitja e automjetit, si shumë të kursyer *cash*, pasi subjekti nuk e ka deklaruar këtë vlerë në DIPP-të e viteve 2013 dhe 2014, por gabimisht dhe pa të drejtë e ka shënuar këtë vlerë si likuiditet në bankë.

Në konkluzion, pas konstatimit të këtij gabimi material dhe saktësimi të tij në analizën financiare, Komisioni rishikoi analizën financiare, e cila rezultoi me balancë negative për vitin 2015 në

shumën 562,653 lekë dhe për periudhën e deklarimit 2003 – 2016, balanca financiare negative rezulton të jetë në shumën – 626,099 lekë.

Përshkrimi	Para 2003	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>Të ardhurat</b>	<b>3 670 309</b>	<b>871 358</b>	<b>985 202</b>	<b>953 442</b>	<b>1 230 938</b>	<b>1 471 440</b>	<b>4 729 202</b>	<b>1 332 228</b>	<b>1 468 357</b>	<b>1 439 148</b>	<b>1 288 202</b>	<b>1 821 856</b>	<b>1 407 603</b>	<b>1 409 399</b>	<b>1 432 811</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	3 188 939	788 294	895 238	856 162	1 118 438	1 343 670	1 207 942	1 181 696	1 311 205	1 275 948	1 288 202	1 321 856	1 407 603	1 409 399	1 432 811
Të ardhura nga pensioni i nënës	481 370	83 064	89 964	97 280	112 500	127 770	136 980	150 532	157 152	163 200					
Të ardhura nga shitja e apartamentit							3 384 280								
Të ardhura nga shitja e mjetit												500 000			
<b>Detyrime</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>6 559 125</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
Kredi në **** Bank dt.03.09.2008 50,000 Euro							6 159 125								
Hua Sh.Sh.							400 000								
<b>Shpenzime</b>	<b>1 502 872</b>	<b>407 728</b>	<b>407 728</b>	<b>439 114</b>	<b>439 114</b>	<b>493 240</b>	<b>1 479 632</b>	<b>960 804</b>	<b>957 845</b>	<b>937 579</b>	<b>809 725</b>	<b>794 291</b>	<b>836 629</b>	<b>861 802</b>	<b>1 268 998</b>
Shpenzime jetike	1 502 872	187 728	187 728	219 114	219 114	273 240	273 240	273 240	273 240	273 240	141 024	141 024	219 998	224 276	235 092
Shpenzime mobilimi							800 000								
Shpenzime udhëtimi								6 472	12 033	7 652	6 287	43 126	7 380	44 003	55 974
Shpenzime kësti i kredisë							186 392	593 092	594 572	590 688	596 414	544 141	543 251	527 523	511 932
Kthimi i huasë															400 000
Shpenzime shëndetësore															
Shpenzime udhëtimi (EL-DR) 2003-2008		220 000	220 000	220 000	220 000	220 000	220 000								
Shpenzime udhëtimi (TR-DR) 2009-2016								88 000	78 000	66 000	66 000	66 000	66 000	66 000	66 000
<b>Pasuri</b>	<b>425 534</b>	<b>-1 777 880</b>	<b>502 673</b>	<b>217 777</b>	<b>289 741</b>	<b>937 246</b>	<b>9 822 980</b>	<b>84 620</b>	<b>307 767</b>	<b>87 549</b>	<b>178 023</b>	<b>172 738</b>	<b>278 892</b>	<b>1 110 251</b>	<b>212 973</b>
Kursime (ndryshim likuiditete)		-1 777 880	502 673	217 777	289 741	437 246	-1 072 840	84 620	307 767	87 549	178 023	172 738	278 892	-224 954	212 973
Apartament banimi 137,4m2, Nj.5, Rr.****							10 895 820								
Apartament banimi 1+1 EKB Elbsan si i pastrehe 08.1993	5 280														
Apartament banimi 73 m2 ( 2+1 ) nga EKB sipas kontratës dt.15.02.2000	420 254														
Autoveturë sipas kontratës nr.*** rep., nr.**** kol., datë 25.10.2007						500 000									
Automjet blerë dt.17.12.2015														1 335 205	
<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</b>		<b>2 241 510</b>	<b>74 801</b>	<b>296 551</b>	<b>502 083</b>	<b>40 954</b>	<b>-14 285</b>	<b>286 804</b>	<b>202 745</b>	<b>414 019</b>	<b>300 454</b>	<b>854 828</b>	<b>292 082</b>	<b>-562 653</b>	<b>-49 161</b>

## B. KONTROLLI I FIGURËS

**8.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka dërguar pranë Komisionit me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.5.2019, raportin nr. \*\*\* prot., datë 24.4.2019, mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Valbon Çekrezi, i deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.5.2019, të KDZH-së dhe nga Grupi i Punës është konkluduar se:

**8.1** Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, është përcjellë në Komisionin raporti për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Valbon Çekrezi me konstatimin “për përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës”.

**8.2** Në vijim përcillet raporti i rishikuar për kontrollin e figurës me kërkesën nr. \*\*\*, datë 1.4.2019, nga Komisioni. Bazuar në informacionin e ardhur nga institucioni i verifikimit rezulton se:

*“Për subjektin e rivlerësimit Valbon Çekrezi, pas verifikimeve të kryera rezulton se disponohen të dhëna \*\*\*\*\*, nga të cilat ngrihen dyshime të arsyeshme për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e korrupsionit pasiv të gjyqtarit në disa procese gjyqësore në Gjykatën e Apelit Durrës. Mbi bazën e të dhënave që disponohen në ngarkim të subjektit të rivlerësimit janë informuar instancat kompetente konkretisht:\*\*\*\*\*. Informacioni i ardhur nga institucioni i verifikimit na bën me dije se i lartpërmenduri duke shfrytëzuar pozitën e tij si gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Durrës në bashkëpunim\*\*\*\*\* dyshohet se ka kryer korrupsion aktiv dhe ushtrim të ndikimit të paligjshëm gjatë gjykimit të një çështjeje mbi pronësinë e një trualli\*\*\*\*. Bazuar në informacionet e siguruar dyshohet se\*\*\*\*\*për gjyqtarin Valbon Çekrezi kundrejt dhënies së vendimit të fundit në favor të personit. Sa më sipër në vlerësim të të dhënave të ardhura pas konstatimit fillestar mbi subjektin e rivlerësimit gjykohet se:*

**a.** Sipas përcaktimit të pikës 8, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, që përfshin veprat penale sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale ngrihen dyshime për përfshirje të mundshme të subjektit të rivlerësimit në veprimtari të kundërligjshme në mënyrë të përsëritur, shfaqur në formën e korrupsionit aktiv dhe pasiv në disa procese gjyqësore.

**b.** \*\*\*\*\*, periudhë për të cilën ka raportime për përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në veprimtari të paligjshme, gjyqtari Çekrezi ka ushtruar detyrën pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

**c.** Vlen për t’u marrë në konsideratë fakti se mbi veprimtarinë e paligjshme të këtij subjekti të rivlerësimit, për periudhën e raportuar është informuar \*\*\*\*\* në cilësinë e autoritetit për trajtim dhe shqyrtim të rasteve të dyshuara të përfshirjes në veprimtari të kundërligjshme të individëve apo grupeve kriminale.

**d.** Të dhënat që disponohen në ngarkim të subjektit të rivlerësimit për implikimin e tij në veprimtari korruptive, pasqyrojnë rrethanat e konstatimit të faktit se ekzistojnë kontakte të papërshtatshme sipas përcaktimit të pikës 6, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016 në formën e një takimi të qëllimshëm, në papajtueshmëri me ushtrimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

**e.** Bazuar në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, ligjvënësi i është referuar kontakteve të papërshtatshme që mund të ketë subjekti i rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Nisur nga qëllimi dhe fryma e ligjit, ku procesi i rivlerësimit përfshin kontrollin tërësor të prokurorëve dhe gjyqtarëve duke filluar nga vetë subjekti e më pas duke zbuluar ose identifikuar lidhjet e subjekteve me krimin e organizuar, rrjedhimisht subjekti i rivlerësimit është subjekt i kontrollit të ligjit dhe i përfshirjes ose jo në krimin e organizuar.

**f.** Informacioni që disponohet në ngarkim të gjyqtarit Valbon Çekrezi për përfshirje në veprimtari korruptive të funksionarit të drejtësisë, në më shumë se një rast, nëpërmjet premtimit apo kërkimit të drejtpërdrejtë apo tërthorazi të çfarëdolloj përfitimi të parregullt për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën e tij funksionale sipas kërkesave të germave ‘b’, ‘e’ dhe ‘c’ të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016 e bën subjektin e rivlerësimit person me tendencë për përfshirje në veprimtari kriminale dhe një individ që mund të vihet nën presion nga strukturat kriminale.

*g. Në konstatimin për përshtatshmëri për vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit janë marrë parasysh elementët që evidentojnë përfshirjen e tij në veprimtari korruptive, pasi në frymën kundër korrupsionit të ligjit nr. 84/2016 vlerësohet se integriteti profesional është element përcaktues për pastërtinë e figurës së subjektit të rivlerësimit. Në këtë këndvështrim, sa i përket informacionit të autoriteteve verifikuese për gjyqtarin Çekrezi, integriteti profesional vlerësohet i pakufizuar në terma kohorë”.*

Mbështetur në pikat e lartpërmendura, Grupi i Punës rishikon konstatimin fillestar të kontrollit të figurës të subjektit të rivlerësimit Valbon Çekrezi nga përshtatshmëri në papërshtatshmëri për vijimin e ushtrimit të detyrës nga ky subjekt.

### **8.3 Verifikime të tjera të Komisionit për subjektin e rivlerësimit lidhur me shtetasin P.C. (në vijim P. C.)**

**8.3.1** Komisioni, gjatë verifikimit të sistemit *TIMS* të subjektit të rivlerësimit, ka konstatuar, ndër të tjera, se subjekti ka udhëtuar me automjetin me targa \*\*\* me dalje datë 15.10.2010 dhe hyrje datë 17.10.2010 nga territori shqiptar nëpërmjet pikës kufitare të Kapshticës.

**8.3.2** Nga verifikimi në sistemin AMF ([www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al)) të targës \*\*\* ka rezultuar automjeti tip “BMW”, i vitit 2010, me pronar shtetasin P. C.

**8.3.3** Komisioni ka verifikuar në rrjetin internet me mjetin e kërkimit “*google*” dhe ka konstatuar se nga informacionet e publikuara në media, ky shtetas rezulton i vrarë në vitin 2013 në një atentat mafioz në qytetin e Durrësit, i dyshuar për përfshirje në një konflikt për trafikun e lëndëve narkotike në shtetin italian<sup>35</sup> dhe se ky shtetas rezulton të jetë dënuar me 14 vjet burg për trafik të lëndëve narkotike në Itali, në vitin 2006.

**8.3.4** Komisioni, në kuadrin e dyshimeve mbi mundësinë e ndonjë kontakti të papërshtatshëm të subjektit të rivlerësimit, me pyetësin nr. 3<sup>36</sup> i ka kërkuar subjektit shpjegime nëse ka njohje personalisht me shtetasin P. C. dhe nëse po, prej sa kohësh dhe çfarë marrëdhëniesh ka me të, a ka pasur shoqëri të vazhdueshme me të, a ka udhëtuar së bashku me shtetasin P. C., si brenda ashtu edhe jashtë shtetit dhe nëse po, të specifikojë destinacionin, ditët e udhëtimit dhe me çfarë mënyre ka udhëtuar.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *“Me shtetasin P.C. nuk kam asnjë njohje personale apo ndonjë marrëdhënie, as shoqërore dhe as të një natyre tjetër. Me këtë shtetas nuk kam pasur asnjëherë shoqëri, për më tepër të vazhdueshme”.*

*“Në tetor të vitit 2010, unë së bashku me dy shokë dhe kolegë të mitë, P.Ç. dhe B.T. kishim vendosur të bënim një vizitë në shtetin grek, në qytetin e S., udhëtim që do ta bënim në rrugë tokësore me automjet. Kemi rënë dakord që të udhëtonim me mjetin që kam pasur në pronësi në atë kohë, me targa \*\*\*.*

*Në datën 15.10.2010 (referuar të dhënave të pasaportës) jemi nisur nga Tirana drejt Kapshticës paradite. Në të hyrë të qytetit të Korçës automjeti ka nisur të japë disa shenja në ekran, duke u ndezur disa nga ikonat që ndodhen në të, të cilat tregonin që diçka nuk ishte në rregull. Kam komunikuar në telefon me një specialist, i cili me ka këshilluar që të mos vijoja udhëtimin me këtë mjet, duke qenë udhëtimi në rrugë të gjatë me këtë gjendje të mjetit nuk ishte i sigurt. Mba mend që kjo situatë ka zgjatur ndoshta disa orë.*

*Në një moment kam konstatuar se P. (një nga shokët me të cilët po udhëtoja) ishte duke biseduar diku më tutje me një person. Më pas ata janë afruar pranë nesh dhe ai na ka prezantuar me personin në fjalë, i cili ishte shtetasi P.C. Ky shtetas ishte duke udhëtuar gjithashtu drejt S. dhe*

<sup>35</sup> <https://shqiptarja.com/lajm/plarent-cani-i-d-euml-nuar-n-euml-itali-br-me-14-vjet-burg-p-euml-r-trafik-droge>

<sup>36</sup> Shihni në dosje deklarinimin e subjektit në pyetësin nr. 3.



*duke qenë se ishte vetëm dhe se do të kthehej sërish në Shqipëri pas pak ditësh është ofruar për të na shoqëruar gjatë rrugës me automjetin që po udhëtonte.*

*Pasi e kemi biseduar mes nesh këtë propozim kemi pranuar të udhëtojmë me automjetin e këtij shtetasi, kurse automjetin tim e kam parkuar te pika e karburantit dhe kam njoftuar me telefon një mikun tim që të vinte për ta marrë.*

*Nuk di të them dhe as nuk mbaj mend të kemi biseduar në lidhje me arsyet se përse shtetasi P. po udhëtonte drejt Greqisë.*

*Gjatë qëndrimit në qytetin e S. kemi shëtitur dhe qëndruar së bashku me kolegët dhe nuk mbaj mend që shtetasi P. të jetë shoqëruar me ne gjatë qëndrimit në këtë qytet. Ditën tjetër ka ardhur dhe më ka takuar në Selanik miku im i vjetër K.M., i cili jeton në Athinë, por ka udhëtuar drejt S. meqenëse unë nuk kisha kohë të shkoja dhe ta takoja. Gjatë asaj dite ai na ka shoqëruar dhe kemi shëtitur së bashku qytetin.*

*Në kthim, që sipas verifikimit që kam bërë në pasaportën që disponoj ka qenë data 17.10.2010, kemi udhëtuar drejt Shqipërisë po me të njëjtin automjet dhe kemi qenë po përsëri të njëjtët persona.*

*Gjatë rrugës si në vajtje dhe në kthim kemi ndaluar për ndonjë pushim të shkurtër dhe për të pirë kafe. Gjatë rrugës dhe pushimeve të shkurtra janë bërë biseda të përgjithshme, me sa mbaj mend.*

*Përtej sa më sipër nuk kam pasur komunikime apo marrëdhënie me shtetasin P.C.*

*Mbjaj mend që në prill të vitit 2011, shtetasi P. ka tentuar të komunikojë me mua për shkak të një procesi gjyqësor që kishte një i afërmi i tij, shtetasi P.L. emrin e të cilit e mbaj mend për shkak të mediatizimit të çështjes, por unë nuk kam pranuar ta takoj këtë person dhe pas këtij udhëtimi nuk e kam takuar në asnjë rrethanë”.*

**8.3.5** Subjekti, në mbështetje të shpjegimeve të tij, ka depozituar: (i) vendimin e datës 18.4.2011 të Gjykatës së Apelit, ku është në cilësinë e kryesuesit të trupës gjyqësore dhe qëndrimi i tij në këtë çështje është në disfavor të shtetasit P. L., për të cilin u tentua që subjekti të kontaktohej nga shtetasi P. C.; (ii) deklaratë noteriale të shtetasit P. Ç., datë 8.1.2021, i cili konfirmon me deklaratimet e tij shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në pyetësin nr. 3<sup>37</sup>.

**8.3.6** Referuar deklaratimeve të subjektit për udhëtimin e tij në të njëjtën datë me shtetasit B. T. dhe P. Ç., Komisioni ka kryer verifikime në sistemin TIMS për shtetasit B. T., P. Ç. dhe P. C. dhe ka rezultuar se të tre këta shtetas, së bashku me subjektin Valbon Çekrezi rezultojnë me dalje nga territori shqiptar nëpërmjet pikës kufitare të Kapshticës më 15.10.2010 dhe me hyrje në territorin shqiptar po nëpërmjet kësaj pike kufitare më 17.10.2010.

**8.3.7** Nisur nga deklaratimet e subjektit që shtetasi P.C. u njoftua nga kolegu P. Ç., Komisioni, me vendimin datë 7.5.2021, ka vendosur të administrojë nga dosja e ish- subjektit të rivlerësimit P. Ç., të hetuar më parë nga Komisioni<sup>38</sup>, përgjigjet e pyetësorit standard me nr. \*\*\* prot., datë 20.2.2018, të depozituar nga subjekti P. Ç. në Komision dhe në pyetjen nr. 9 ku subjekti P. Ç. sqaron udhëtimet e tij, në pikën 3 deklaron dalje/hyrje në vitin 2011, udhëtim i shoqëruar “nga një mik P. C., i cili ka ndërruar jetë”.

---

<sup>37</sup> i) Vendimi nr. \*\*\*, datë 18.4.2011, i Gjykatës së Apelit ku subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesues i trupit gjyqësor në çështjen me kërkues Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës me objekt “vleftësim mase arresti në flagrancë, caktim mase sigurimi arrest në burg” ndaj të dyshuarit P. L., i dyshuar për veprat penale “ushtrim të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike etj.”. Gjykata e Apelit, me kryesues të trupit gjyqësor subjektin Valbon Çekrezi, ka vendosur “miratimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 22.3.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës”.

ii) Deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 8.1.2021, me deklaratues P. Ç., i cili deklaron, ndër të tjera, se është ai që ka kontaktuar me shtetasin P. C., të cilin e njihje personalisht dhe u ka mundësuar vajtjen dhe ardhjen nga S. (shihni deklaratën noteriale të dorëzuar me pyetësin nr. 3 në dosje).

<sup>38</sup> Vendimi nr. \*\*\*, datë 27.9.2019, i Komisionit për subjektin P.Ç.

**8.3.8** Komisioni, gjithashtu, ka administruar përgjigjen e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (PPKKKO) në lidhje me procedime penale, kërkesa për gjykim dhe vendime mosfillimi/pushimi për shtetasin P. C., si dhe Gjykatës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (GJPKKKO)<sup>39</sup> për procese gjyqësore apo vendime penale lidhur me shtetasin P. C.

**8.3.9** PPKKKO-ja, në përgjigje të saj, ka konfirmuar se nga verifikimi nuk rezulton se pranë kësaj prokurorie të jetë regjistruar ndonjë procedim penal në ngarkim të këtij shtetasi.

**8.3.10** GJPKKKO-ja ka konfirmuar se ndaj këtij shtetasi nuk rezulton të jenë dhënë vendime nga kjo gjykatë, si dhe nuk rezulton që të jetë aktualisht në gjykim.

**8.3.11** Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, ka konstatuar se: (i) bazuar në raportin e DSIK-së ka bërë hetime duke kërkuar dosjet respektive, të cilat janë analizuar te kriteri i vlerësimit profesional edhe referuar këtij raporti; (ii) mbeten dyshime në lidhje me faktin e njohjes dhe shoqërimit rastësor apo në vazhdimësi të këtij personi, shtetasit P.C., me subjektin e rivlerësimit dhe me dy subjekte të tjera, duke u siguruar dhe udhëtimin atyre për në Greqi si në vajtje ashtu edhe në kthim.

Për këtë qëllim Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë komente dhe shpjegime të detajuara dhe shteruese, shoqëruar me prova shkresore, në lidhje me shtetasin P. C., si dhe të japë komente dhe shpjegime të detajuara, shoqëruar me prova shkresore, në lidhje me çdo konstatim në raportin e DSIK-së, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**8.4** Në shpjegimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka theksuar se konstatimet e DSIK-së nuk kanë asnjë bazë dhe janë jo vetëm të pasakta, por edhe të mbështetura në vlerësime dhe konsiderata subjektive: *“Dua të theksoj se gjatë gjithë veprimtarisë sime si gjyqtar e kam ushtruar këtë detyrë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e dala në zbatim të saj, duke treguar veçanërisht integritet dhe duke zgjidhur çështjet bazuar mbi vlerësimin e pavarur dhe të paanshëm të provave dhe zbatimit të ligjit.*

*Gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarie nuk kam pasur ‘kontakte të papërshtatshme’ në kuptim të ligjit nr. 84/2016, nuk jam përfshirë në asnjë veprimtari korruptive dhe as nuk kam lejuar askënd të më ndërhyjë në detyrën time si gjyqtar. Në raport nuk gjej asnjë provë, indicie apo të dhënë, burimin nga janë nxjerrë ato dhe organin shtetëror që i ka administruar këto të dhëna që më pas janë marrë dhe përdorur nga ana e DSIK-së në këtë raport. Në këtë situatë më duhet të hamendësoj dhe e kam të pamundur të paraqes kundërshtimet e mia në lidhje me fakte e të dhëna konkrete, mbi ligjshmërinë e tyre dhe mënyrën se si janë administruar.*

*Vlerësimi për ‘përfshirje të mundshme të subjektit të rivlerësimit në veprimtari të kundërligjshme në mënyrë të përsëritur...’ nuk i referohet asnjë fakti, veprimi, rrethane apo kohe konkrete të përcaktuar. Gjuha subjektive dhe përgjithësuese në përmbajtjen e këtij raporti e bën më të qartë mungesën e çfarëdo të dhëne konkrete që të mbështesë aludimet e këtij organi.*

*Fillimisht, në raport thuhet se veprimtaria është shfaqur në formën e korrupsionit pasiv të gjyqtarit e më tej se është kryer korrupsion aktiv në bashkëpunim.*

*Korrupsioni pasiv dhe ai aktiv janë dy vepra të ndryshme penale, që dallojnë për sa i përket anës objektive të tyre. Ekzistenca e elementeve të këtyre veprave penale dhe i përcaktimit të përfshirjes së personit në kryerjen e tyre dhe fajësisë së tij është kompetencë e organeve të ndjekjes penale dhe e gjykatës kompetente. Unë nuk jam pyetur në asnjë cilësi dhe nuk jam informuar asnjëherë për ndonjë procedim penal që lidhej me personin tim gjatë ushtrimit të detyrës.*

<sup>39</sup> Përgjigjja nr. \*\*\* prot., datë 7.1.2021, e PPKKKO-së; përgjigjja nr. \*\*\* prot., datë 31.12.2020, e GJPKKKO-së.

Bazuar edhe në konstatimet e tjera të relacionit të KPK-së, më lind dyshimi se raporti i DSIK-së i referohet procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Apelit Durrës me palë: paditës: B.Xh.S., përfaqësuar me av. N.T.; të paditur: N.Z.F.; A.Z.T.; ATP Tiranë; persona të tretë: ZVRPP Durrës; objekti: anulimi i pjesshëm (vetëm për pjesën e mbivendosur) i vendimit nr. \*\*\*, datë 11.3.1994, i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, pranë Bashkisë Durrës. Çregjistrimi i sip. 402 m<sup>2</sup> që është në emër të z. N.F. (T.) dhe regjistrimi i saj në emër të z. B.S. në ZVRPP Durrës. Detyrimi i të paditurve të njohin pronar paditësin B.S. për sip. 402 m<sup>2</sup>.

Në lidhje me këtë çështje, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.5.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së paditësit B.S. Kundër këtij vendimi paditësi B.S. ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Durrës, çështje ku jam caktuar si gjyqtar relator.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj çështjeje, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se është rezultat i respektimit të normave procedurale, si dhe i zbatimit të drejtë të ligjit material (bashkëlidhur vendimi nr. \*\*\*, datë 5.10.2017, i Gjykatës së Apelit Durrës). Në lidhje me këtë çështje gjyqësore nuk i njoh personalisht palët ndërsa me përfaqësuesit e tyre përveçse komunikimeve gjatë seancave gjyqësore në proceset gjyqësore që ata përfaqësojnë, nuk kam pasur asnjë lloj kontakti në lidhje me këtë çështje apo për çfarëdo arsye tjetër, qoftë edhe të rastësishme, jashtë seancave gjyqësore.

Edhe nga korrespondenca juaj në lidhje me këtë çështje me organet kompetente ka rezultuar qartësisht se nuk ka asnjë të dhënë që të ngrejë qoftë ndonjë dyshim në lidhje me ndonjë veprimtari korruptive apo të kundërligjshme në ngarkim të personit tim.

Vlerësimet në raportin e DSIK-së janë abuzive dhe me nota të theksuara subjektivizmi. Konsideratat se 'informacioni që disponohet në ngarkim të gjyqtarit Valbon Çekrezi për përfshirje në veprimtari korruptive të funksionarit të drejtësisë, në më shumë se një rast, nëpërmjet premtimit apo kërkimit të drejtpërdrejtë apo tërthorazi të çfarëdolloj përfitimit të parregullt për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën e tij funksionale sipas kërkesave të germave 'b', 'e', 'c' të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016 e bën subjektin e rivlerësimit person me tendenca për përfshirje në veprimtari kriminale dhe një individ që mund të vihet nën presion nga strukturat kriminale' është i papranueshëm dhe është thjesht një perifrachim i përmbajtjes së nenit 37 të ligjit nr. 84/2016.

Sipas nenit 34 të ligjit nr. 84/2016, objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Ndërkohë që në raportin e tij DSIK-ja, duke dalë tej kompetencave dhe fushës së veprimtarisë në kuptim të këtij ligji ka abstraguar në lidhje me personin tim, duke përdorur dyshime të ngritura prej tyre për të bërë analiza psikologjike në lidhje me 'tendencat e mia për t'u përfshirë në veprimtari kriminale'.

Në të gjithë këtë raport nuk ka asnjë provë apo të dhënë konkrete nga institucione të ndjekjes penale ose organe ligjzbatuese që të cenojë figurën morale dhe integritetin tim si gjyqtar. Informacioni i përcjellë nga DSIK-ja nuk i është përmbajtur kërkesave dhe parashikimeve të neneve 34 dhe 38 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk referon në asnjë moment se cilët janë personat e përfshirë në krimin e organizuar, me të cilët subjekti ka pasur kontakte të papërshtatshme apo ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri, çka është edhe qëllimi i këtij kontrolli dhe objekt i veprimtarisë së këtij organi.

Madje konstatoj se në bazë të informacionit të përcjellë nga Prokuroria e Posaçme pranë jush në lidhje me procedimin penal të regjistruar mbi kallëzimin e shtetasit B.S., që ka pasur cilësinë e paditësit në procesin gjyqësor të sipërcituar, nuk ekzistojnë as indicie për ekzistencën e ndonjë dyshimi ndaj meje për kryerje të veprimeve nga ana ime që nuk janë në pajtim me ushtrimin e detyrës, duke mos u ndodhur në situatën e parashikuar nga neni 3, pika 6 dhe neni 34 të ligjit nr. 84/2016.

*Ky raport jo vetëm që nuk provon dyshimet e ngritura, por nuk evidenton ndonjë rrethanë konkrete të aftë për të më ngarkuar me përgjegjësi në kuptim të parashikimeve të ligjit nr. 84/2016”.*

Në lidhje me shtetasin P. C., subjekti i rivlerësimit ka dhënë të njëjtat shpjegime me ato të dhëna më parë në pyetësin nr. 3, që janë të përmbledhura në pikën 8.3 të vendimit.

Po në lidhje me këtë shtetas, në lidhje me çështjen gjyqësore të shtetasit P. L., subjekti u pyet në seancë dëgjimore nëse është kontaktuar direkt nga shtetasi P. C. dhe u shpreh se u qëndronte deklarimeve të bëra në përgjigje të rezultateve të hetimit, ku ka sqaruar se nuk ka pranuar të takojë shtetasin P. C. dhe se atij i është dërguar fjalë nëpërmjet personave të tretë.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

**8.5** Komisioni vëren se për sa i përket shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit lidhur me raportin e DSIK-së, janë të plota dhe bindëse.

Komisioni vlerëson se nga hetimi administrativ i kryer, si dhe duke marrë në konsideratë shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, nuk u gjetën elementë që të vërtetojnë përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në raste korruptive, ushtrim ndikimi të paligjshëm, si dhe që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Gjithashtu, nuk u konstatuan mangësi nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës. Pas hetimit të kryer nga Komisioni, konstatohet se subjekti i rivlerësimit Valbon Çekrezi, është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës.

Komisioni konstaton se të dhënat e referuara në raportin e DSIK-së referojnë në dyshime për veprime të paligjshme, me natyrë korruptive dhe ndikim të paligjshëm në disa çështje gjyqësore. Komisioni, në lidhje me informacionin e referuar, ka kryer hetime të thelluara dhe të plota të pasqyruara si më lart dhe nuk u arrit në përfundimin që këto të dhëna të referuara në raportin e DSIK-së të provojnë implikimin e subjektit të rivlerësimit në veprime të paligjshme me natyrë korruptive, ndikim të paligjshëm apo dhe kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Nga hetimi i kryer nga Komisioni rezultoi se:

a) Nuk u provua favorizimi i personave të ndryshëm në procese gjyqësore. Nga korrespondencat e kryera me organet ligjzbatuese nuk u provua pjesëmarrja e subjektit të rivlerësimit qoftë si gjyqtar i vetëm apo edhe si anëtar trupe gjyqësore, në disa procese gjyqësore ku kanë qenë palë subjektet e referuara në raport.

b) Nuk u provua ushtrimi i ndikimit të paligjshëm që lidhet drejtpërdrejt me detyrën funksionale të subjektit të subjekte të tjera rivlerësimi, gjyqtarë apo prokurorë. Edhe në një rast të konstatuar në raport nuk vërtetohet, qoftë nga organet ligjzbatuese, ashtu edhe nga hetimi i Komisionit, lidhja shkak-pasojë, nuk vërtetohet lidhja konkluzive ndërmjet marrjes përsipër për dhënien e ndihmës, kontaktimit të ndonjë subjekti rivlerësimi, gjyqtar (anëtar trupe gjyqësore), kërkimit për të favorizuar një palë ndërgjyqëse, si dhe dhënia e një vendimi gjyqësor në favor të palës ndërgjyqëse si rezultat i ushtrimit të ndikimit të paligjshëm nga subjekti i rivlerësimit. Përderisa nga hetimi nuk rezultoi e provuar lidhja shkak-pasojë, e argumentuar si më sipër, është e pamundur t’i atribuohet subjektit të rivlerësimit vepra e ushtrimit të ndikimit të paligjshëm.

Vlen të theksojmë se shtetasit që supozohet se është favorizuar nga subjekti për një çështje civile, i është rrëzuar padia nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës, ku subjekti ka qenë anëtar trupe.

c) Nuk u provua ekzistenca e kontakteve të papërshtatshme dhe mosdeklarimi i tyre në deklaratën e kontrollit të figurës. Nga i gjithë hetimi i thelluar i kryer nga Komisioni, përfshirë edhe

korrespondencën me organet ligjzbatuese, nuk rezultoi që subjektet e përmendura në raport të ishin të përfshirë në krimin e organizuar dhe, për rrjedhojë, që subjekti i rivlerësimit të kishte kontakte të papërshtatshme me ta. Nuk rezultoi që për këto subjekte të ishin marrë vendime apo të ishin regjistruar si të proceduar për vepra penale që kanë të bëjnë me krimin e organizuar.

Në lidhje me kontaktin me shtetasin P.C., marrë shkas nga të dhënat mediatike jo të konfirmuara zyrtarisht se ka qenë i dënuar në vitin 2006 në Itali me 14 vjet burg për trafik droge, gjithashtu edhe nga korrespondencat me organet ligjzbatuese të shtetit shqiptar sipas të cilave ky shtetas nuk rezultoi i dënuar apo i proceduar për vepra që lidhen me krimin e organizuar, Komisioni, pasi analizoi provat dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, i konsideron të plota dhe bindëse.

Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë apo të dyshuar si të përfshirë në krimin e organizuar. Edhe nëse për një rast do të supozohej se ekzistonte një kontakt i tillë, nuk u provua asnjë nga rrethanat e parashikuara në pikën 4, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016 dhe e gjithë situata e kontaktit me shtetasin P.C. gjen dakordësi me germën “a”, të pikës 5, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016 (rrethanat lehtësuese që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar)<sup>40</sup>. Ky përfundim përforcohet edhe nga fakti se në një procedurë tjetër hetimi administrativ për subjektin P.C., i cili ka udhëtuar me subjektin dhe një tjetër me shtetasin P.C. për në Greqi, hetim ky i pavarur nga hetimi administrativ i kryer për subjektin Valbon Çekrezi, ish-subjekti e ka deklaruar shtetasin P.C. si një mik të tij, fakt që e ka konfirmuar përsëri nëpërmjet deklaratës noteriale datë 8.1.2021.

**Komisioni vëren se nga hetimet e kryera, analiza e shpjegimeve të subjektit dhe e provave të vëna në dispozicion, nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur kontakte të papërshtatshme në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, të jetë përfshirë në veprime korruptive apo të ketë kryer veprime me qëllim ushtrimin e ndikimit të paligjshëm në çështje gjyqësore.**

**Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm për kriterin e figurës.**

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**9. Grupi i Punës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, ka hartuar raportin me nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2021, për të analizuar aftësitë profesionale për subjektin e rivlerësimit Valbon Çekrezi.**

Ky raport i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterit të: (a) aftësive profesionale<sup>41</sup>; (b) aftësive organizative<sup>42</sup>; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale<sup>43</sup>; (d) aftësive personale dhe angazhimit profesional<sup>44</sup>.

<sup>40</sup>Subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të besueshme, parashtron se nuk është në dijeni se personi është i përfshirë në krimin e organizuar.

<sup>41</sup>Subjekti i rivlerësimit Valbon Çekrezi ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Ka aftësi në arsyetim ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij janë të qarta dhe të kuptueshme.

<sup>42</sup>Subjekti i rivlerësimit ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë. Në periudhën e rivlerësimit i janë caktuar për gjykim gjithsej 898 çështje (periudha 2014 – 2016) dhe ka përfunduar si relator 855 çështje, si dhe ka mbartur në vitin e fundit të detyrës 13 çështje. Rendimenti i përfundimit të çështjeve bazuar në këto të dhëna është 95.2 %. Ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Dokumentacioni në dosje është i rregullt, i saktë dhe i plotë.

<sup>43</sup>Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit Valbon Çekrezi. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Valbon Çekrezi dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit.

<sup>44</sup>Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor në format letër, është konstatuar se komunikimi ka qenë i qartë dhe i rregullt dhe nuk janë konstatuar të dhëna të drejtpërdrejta mbi aftësinë e subjektit Valbon Çekrezi për të bashkëpunuar

**9.1** Grupi vlerësues pranë KLGJ-së ka analizuar tri dokumentet e paraqitura nga subjekti dhe konkretisht:

- i. vendimi nr. \*\*\*, datë 6.12.2016, i Gjykatës së Apelit Durrës<sup>45</sup>, ku subjekti ka qenë relator i çështjes;
- ii. vendimi nr. \*\*\*, datë 24.7.2015, i Gjykatës së Apelit Durrës<sup>46</sup>, ku subjekti ka qenë relator i çështjes;
- iii. vendimi nr. \*\*\*, datë 3.12.2014, i Gjykatës së Apelit Durrës<sup>47</sup>, ku subjekti ka qenë relator i çështjes.

**Komisioni vëren se pas administrimit të dokumentacionit dhe raportit të vlerësimit profesional dhe analizës përkatëse nuk konstatohen problematika lidhur me tri dokumentet e subjektit të rivlerësimit.**

**9.2** Grupi vlerësues pranë KLGJ-së ka analizuar edhe pesë dosje të përzgjedhura sipas një sistemi rastësor dhe objektiv.

**9.2.1** Dosja 1 – çështja civile nr. \*\*\* regj. them., datë 29.3.2012 regjistrimi<sup>48</sup>, caktuar subjektit Valbon Çekrezi. Nga Grupi i Punës pranë KLGJ-së dhe nga hetimi i kryer pas administrimit të dokumentacionit në dosje është konstatuar:

Vendimi (i shpallur datë 16.9.2014) i arsyetuar është dorëzuar në kryesekretari nga subjekti i rivlerësimit në datën 6.10.2014 – pas 20 ditëve nga shpallja, jashtë afatit 10-ditor ligjor të përcaktuar nga neni 308/2 i Kodit të Procedurës Civile.

Në dispozitiv nuk disponohet për të drejtën e rekursit dhe për shpenzimet gjyqësore, duke mos plotësuar të gjitha elementet e kërkuara nga nenet 310 dhe 472 të Kodit të Procedurës Civile.

**9.2.2** Dosja 2 – çështja civile nr. \*\*\* regj. them., datë 11.6.2012 regjistrimi<sup>49</sup>, nga Grupi i Punës pranë KLGJ-së dhe nga hetimi i kryer pas administrimit të dokumentacionit në dosje është evidentuar se:

Vendimi (i shpallur datë 24.2.2015) i arsyetuar është dorëzuar në kryesekretari nga subjekti i rivlerësimit në datën 9.3.2015 – pas 13 ditëve nga shpallja, jashtë afatit 10- ditor ligjor të përcaktuar nga neni 308/2 i Kodit të Procedurës Civile.

Në dispozitiv nuk disponohet për të drejtën e rekursit dhe për shpenzimet gjyqësore, duke mos plotësuar të gjitha elementet e kërkuara nga nenet 310 dhe 472 të Kodit të Procedurës Civile.

**9.2.3** Dosja 3 – çështja penale nr. \*\*\* regj. them., datë 12.09.2011 regjistrimi<sup>50</sup>, nga Grupi i Punës pranë KLGJ-së dhe nga hetimi i kryer pas administrimit të dokumentacionit në dosje është konstatuar se:

---

me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Për shkak të funksionit, vazhdimisht merr pjesë në trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës.

<sup>45</sup>Me paditës M. A. etj., i paditur H. F., ZVRPP-ja Elbasan, me objekt “zgjidhjen e kontratës së shitjes, kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, si dhe shpërblim dëmi”.

<sup>46</sup>Ndaj të pandehurve S. Z., etj., të akuzuar për veprat penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve në bashkëpunim” dhe “moskallëzim i krimit”, të parashikuara nga nenet 283/2 dhe 300/1 të Kodit Penal.

<sup>47</sup>Që i përket kërkuarit Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me objekt “vleftësim arresti në flagrancë dhe caktim mase sigurimi ndaj të dyshuarit F. A., për veprën penale “shpërdorim të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal”.

<sup>48</sup>Që i përket paditëses A. Sh. kundër të paditurit E. Sh., me objekt “zgjidhje martesë pa përcaktuar fajësinë, lënien e fëmijës për rritje dhe edukim, detyrimin ushqimor e të drejtën e takimit me fëmijën”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.9.2014.

<sup>49</sup>Që i përket paditëses E. S. etj., kundër të paditurës A. Sh., me objekt “detyrimin të paguajë qiranë e dyqanit nga data 1.5.2008, në shumën 40.000 lekë/muaj”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.2.2015.

<sup>50</sup>Kundër të pandehurve Y., H., A. dhe I.D. të akuzuar për veprat penale “plagosje të lehtë me dashje në bashkëpunim” dhe “shkatërrim të pronës në bashkëpunim”, të parashikuara nga neni 89 e 25 dhe 150 e 25 të Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.12.2013.

Seancat gjyqësore (dy të tilla) kanë filluar me vonesë dhe shkaku i vonesës nuk është relatuar dhe pasqyruar në procesverbal<sup>51</sup>.

Vendimi (i shpallur datë 5.12.2013) i arsyetuar është dorëzuar në kryesekretari nga subjekti i rivlerësimit në datën 27.12.2013 – pas 22 ditëve, jashtë afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Në dispozitiv nuk disponohet për të drejtën e rekursit dhe për shpenzimet gjyqësore, duke mos plotësuar të gjitha elementet e kërkuara nga nenet 310 dhe 472 të Kodit të Procedurës Civile.

**9.2.4** Dosja 4 – çështja penale nr. \*\*\* regj., them., datë 17.6.2015 regjistrimi<sup>52</sup>, nga Grupi i Punës pranë KLGJ-së dhe nga hetimi i kryer pas administrimit të dokumentacionit në dosje është konstatuar:

Seancat gjyqësore (5 të tilla) kanë filluar me mjaft vonesë dhe shkaku i vonesës nuk është relatuar dhe pasqyruar në procesverbal<sup>53</sup>.

Vendimi (i shpallur datë 23.12.2013) i arsyetuar është dorëzuar në kryesekretari nga subjekti i rivlerësimit në datën 5.1.2016 – pas 12 ditëve, jashtë afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit Valbon Çekrezi ka zgjatur gjithsej 6 muaj e 6 ditë, jashtë afatit standard kohor 6-mujor të përcaktuar nga germa “g”, e pikës 5, e Aneksit I të Sistemit të Vlerësimit.

**9.2.5** Dosja 5 – çështja administrative penale nr. \*\*\* regj. them., datë 27.11.2014 regjistrimi<sup>54</sup>, nga Grupi i Punës pranë KLGJ-së dhe nga hetimi i kryer pas administrimit të dokumentacionit në dosje janë konstatuar:

Seancat gjyqësore (2 të tilla) kanë filluar me vonesë dhe shkaku i vonesës nuk është relatuar dhe as pasqyruar në procesverbal<sup>55</sup>.

Vendimi (i shpallur më 4.12.2014) i arsyetuar është dorëzuar në kryesekretari nga subjekti i rivlerësimit në datën 11.12.2014 – pas 7 ditëve, jashtë afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Komisioni, në lidhje me konstatimet si më sipër, i ka kërkuar subjektit shpjegime bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

---

<sup>51</sup>Seanca 1 e datës 14.11.2013 e caktuar në orën 11:30 është çelur në orën 12:41 (me 1 orë e 11 minuta vonesë dhe shkaku i vonesës nuk është relatuar). Seanca 2 e datës 5.12.2013 e caktuar në orën 12:15 është çelur në orën 12:35 (me 20 minuta vonesë dhe shkaku i vonesës nuk është relatuar).

<sup>52</sup>Kundër të pandehurit E. Ç., i akuzuar për veprën penale “prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.12.2015.

<sup>53</sup>Seanca 1 e datës 28.10.2015, e caktuar në orën 11:30 është çelur në orën 12:35 (me 1 orë e 5 minuta vonesë dhe shkaku i vonesës nuk është relatuar) dhe është dokumentuar me procesverbal. Seanca 2 e datës 11.11.2015, e caktuar në orën 11:45 është çelur në orën 13:16 (me 1 orë e 31 minuta vonesë dhe shkaku i vonesës nuk është relatuar) dhe është dokumentuar me procesverbal. Seanca 3 e datës 23.11.2015, e caktuar në orën 13:15 është çelur në orën 13:30 (me 15 minuta vonesë) dhe është dokumentuar me procesverbal dhe regjistrim audio në sallën civile. Seanca 4 e datës 9.12.2015, e caktuar në orën 09:45 është çelur në orën 10:19 (me 34 minuta vonesë dhe shkaku i vonesës nuk është relatuar) dhe është dokumentuar me procesverbal. Seanca 5 e datës 23.12.2015, e caktuar në orën 12:15 është çelur në orën 12:39 (me 24 minuta vonesë dhe shkaku i vonesës nuk është relatuar) dhe është dokumentuar me procesverbal.

<sup>54</sup>Që i përket ankueses S.M., me objekt “ankim ndaj vendimit të Prokurorisë Durrës datë 21.9.2014 për zgjatjen e afatit të hetimeve paraprake në procedimin penal nr. \*\*\*”, përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.12.2014.

<sup>55</sup>Seanca 1 gjyqësore e datës 3.12.2014 e caktuar në orën 12:45 është çelur në orën 13:55 (me 1 orë e 10 minuta dhe shkaku i vonesës nuk është relatuar) dhe është dokumentuar me procesverbal. Seanca 2 gjyqësore e datës 4.12.2014, e caktuar në orën 13:50 është çelur në orën 14:39 (me 49 minuta vonesë dhe shkaku i vonesës nuk është relatuar) dhe është dokumentuar me procesverbal me regjistrim audio.

## Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

**9.3** Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se lidhur me dorëzimin tej afatit ligjor të vendimit të arsyetuar në seancën gjyqësore, ndër të tjera, ka sqaruar se ligjet procedurale për periudhën e rivlerësimit nuk kanë pasur të përcaktuar shprehimisht afat për dorëzimin e vendimit përfundimtar të arsyetuar nga gjyqtari i gjykatës së apelit ndryshe nga gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, si dhe ndryshe nga sa parashikohet sot me ndryshimet e bëra në vitin 2017, ku afati përcaktohet 30 ditë. Subjekti shpjegon se i rezulton që në rastet e evidentuara t'i ketë dorëzuar vendimet e arsyetuara brenda një afati të arsyeshëm 20-ditor. Subjekti ka sqaruar se ndikim ka pasur edhe ngarkesa në punë, ku përgjatë periudhës së rivlerësimit ka përfunduar 845 çështje, ngarkesë e cila bazuar në sistemin e vlerësimit ka qenë mbi standardin sasior. Po kështu, gjatë periudhës së rivlerësimit nga ish-KLD-ja ka qenë caktuar për të gjykuar çështje edhe në gjykata të tjera të apelit, si dhe i angazhuar edhe si gjyqtar i kolegjit zgjedhor, gjë e cila sillte konsumin e ditëve të caktuara në Gjykatën e Apelit Durrës.

Lidhur me mosshënimin në vendimet civile të së drejtës së rekursit dhe për shpenzimet gjyqësore, subjekti ka shpjeguar se shpenzimet gjyqësore bëhen pjesë e vendimmarrjes dhe janë elemente të dispozitivit të vendimit të gjykatës së apelit, pra kjo e fundit shprehet në lidhje me to, vetëm nëse në ankim ka pretendime për mënyrën e llogaritjes ose disponimin e gjykatës së shkallës së parë. Pas ndryshimeve që i janë bërë Kodit të Procedurës Civile me ligjin nr. 38/2017, është parashikuar shprehimisht në pikën 4 të nenit 465, e drejta e palëve për të kërkuar edhe shpenzimet gjyqësore në gjykatën e apelit.

Lidhur me të drejtën për të ushtruar rekurs, subjekti ka shpjeguar se edhe pse sipas parashikimit të nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile si element i vendimit është edhe e drejta për të paraqitur ankim dhe afati i tij, kjo dispozitë procedurale i referohet asaj pjese të Kodit të Procedurës Civile që rregullon gjykimin në shkallë të parë, dispozita që në gjykimin në apel janë të zbatueshme për aq sa është e mundur. Në rastin e vendimit gjyqësor civil, dispozita që rregullon vendimmarrjen e gjykatës së apelit është neni 466 i Kodit të Procedurës Civile. Mosparashikimi i këtij parashikimi në vendim nuk sjell asnjë pasojë për palët për sa kohë që e drejta për të ushtruar rekurs dhe afati i paraqitjes së tij buron nga ligji dhe jo nga disponimi i gjykatës, e cila nuk mund të lejojë apo kufizojë ushtrimin e kësaj të drejte me anë të disponimit të saj.

Lidhur me konstatimin e fillimit me vonesë të seancave gjyqësore dhe mosrelatimit të shkakut të vonesës, subjekti ka shpjeguar se kalendari i seancave gjyqësore përcaktohet nga gjyqtari relator duke pasur parasysh numrin e çështjeve dhe kohën mesatare të zhvillimit të një seance. Gjithashtu, për shkak se gjykimi në apel bëhet nga 3 gjyqtarë sjell planifikimin e një numri të konsiderueshëm çështjesh për trupin gjykues, përgjithësisht jo më pak se 15 çështje. Gjyqtari e ka të pamundur të llogarisë me saktësi kohëzgjatjen e një seance të caktuar, pasi kjo gjë varet nga shkaqe objektive<sup>56</sup>. Po kështu, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.5.2016, Inspektorati ka çmuar se konsiderohen vonesa në fillimin e seancave gjyqësore, vonesat mbi 15 minuta. Vonesat në fillimin e seancës gjyqësore për shkak të kohëzgjatjes së seancave pararendëse, duke mos pasur shkaqe siç mund të jenë ndërprerja e seancave apo veprime të tjera të trupës gjyqësore, nuk gjejnë pasqyrim në procesverbal, ndërkohë që në çdo rast ora e seancës gjen pasqyrim në procesverbalin e seancës gjyqësore.

Lidhur me kohëzgjatjen e një gjykimi penal jashtë afatit standard kohor 6-mujor e përcaktuar nga germa “g” e pikës 5 të Aneksit I të Sistemit të Vlerësimit, subjekti shpjegon se gjykimi i asaj çështjeje konkrete ka zgjatur në fakt 6 muaj e 6 ditë, pra vetëm 6 ditë tej afatit standard kohor, pra cenimi i afatit standard kohor është i papërfillshëm. Afati i standardit kohor është një standard orientues, çka do të thotë se nuk është një afat ligjor, por një afat mbi të cilin vlerësuesi, mbi të

<sup>56</sup>Ndodh që seanca të zgjatet në kohë, nisur nga natyra e çështjes dhe faza ku ndodhet dhe veprimet që do kryhen në atë seancë, vonesat e palëve, parashtrimet e tejzgjatura të tyre, debatet gjyqësore dhe debatet mes palëve, pyetjet e trupës gjyqësore, koha e gjatë e parashtrimit nga palët ose subjektet e tjera, kompleksiteti i çështjes etj.



dhëna tërësore të këtij karakteri, mund të arrijë në përfundime të caktuara mbi aftësitë organizative të gjyqtarit. Vonesa në përfundimin e gjykimit, siç mund të konstatohet, ka ardhur për shkaqe të pavarura nga subjekti si gjyqtar.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

**9.4** Komisioni, referuar dorëzimit të vendimeve të arsyetuara në sekretarinë gjyqësore jashtë afatit të përcaktuar nga Kodi i Procedurës Civile vlerëson se subjekti ka shpjeguar qartë shkaqet për rastet e evidentuara që në tërësinë e tyre janë shkaqe objektive, të cilat nuk vareshin prej tij si gjyqtar.

Në lidhje me mosshënimin e shpenzimeve gjyqësore dhe të drejtën e rekursit, subjekti ka shpjeguar qartë se këto elemente nuk cenojnë si të drejtën e palëve për shpenzimet gjyqësore ashtu edhe të drejtën e rekursit, pasi janë të drejta të përcaktuara në ligj.

Për fillimin me vonesë të seancave gjyqësore kjo kanë qenë për shkaqe subjektive, të pavarura nga subjekti. Pavarësisht kësaj duhet mbajtur në konsideratë orientimi i ish- Inspektoratit të KLD-së, i cili me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.5.2016, ka çmuar se konsiderohen vonesa në fillimin e seancave gjyqësore vonesat mbi 15 minuta, për më tepër që vetë subjekti gjithmonë ka qenë i kujdesshëm të pasqyrojë në procesverbal orën e fillimit të seancës.

Në lidhje me kohëzgjatjen e një gjykimi tej afatit të përcaktuar ligjor (6-mujor) me 6 ditë, përveçse është një tejkalim i papërfillshëm, ka ardhur për shkaqe të pavarura nga vetë subjekti.

**Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me konstatimet e mësipërme, të cilat në një vlerësim tërësor në lidhje me kriterin profesional, vlerësohen në një nivel të papërfillshëm dhe, për rrjedhojë, nuk mund të përbejnë shkak për të ngarkuar subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore në lidhje me këtë kriter.**

### **Të dhëna nga burime arkivore të KLD-së**

**10.** Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Valbon Çekrezi janë paraqitur gjithsej 5 ankesa (2 të vitit 2015 dhe 3 të vitit 2016) në Inspektoratin e ish-KLD-së, nga të cilat 2 ankesa të vitit 2015 janë bashkuar me ankesën bazë, e cila është ankesë për tjetër trup gjykues. Për vitin 2016, 2 ankesa verifikuar për zvarritje gjykimi dhe në përfundim është vendosur arkivimi, pasi nuk rezultuan shkelje nga ana e gjyqtarit Valbon Çekrezi dhe 1 ankesë verifikuar për mosrespektim formal ligji është mbajtur në verifikim në vijim deri në përfundim të gjykimit në Gjykatën e Lartë. Më pas, me krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kjo praktikë i është dërguar për kompetencë këtij institucioni me shkresën përcjellëse nr. \*\*\* prot., datë 6.7.2020, shoqëruar me procesverbalin nr. \*\*\* prot., datë 28.7.2020.

**10.1** Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Valbon Çekrezi, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është paraqitur asnjë kërkesë për procedim disiplinor nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë marrë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

### **Konstatime të tjera**

**11.** Komisioni, nisur nga disa *indicie* të marra nga organe të tjera, ka konsideruar të arsyeshme të kryejë hetime të mëtejshme për verifikimin e disa çështjeve civile/penale duke i analizuar sipas kriterit profesional.

**11.1** Çështja civile me palë paditëse B. S. (përfaqësuar nga av. N. T.), i paditur N. F. dhe A. T. dhe ATP Tiranë me objekt “anulimin e pjesshëm (vetëm të pjesës së mbivendosur) të vendimit nr. \*\*\*, datë 11.3.1994, të KKKPronave, Bashkia Durrës, çregjistrimin e sip. 402 m<sup>2</sup> që është në emër të N. F. dhe regjistrimi i saj në emër të B. S. për sip. 402 m<sup>2</sup>”.

**11.1.1** Komisioni ka administruar vendimin nr. \*\*\*, datë 5.10.2017, të dhënë nga Gjykata e Apelit Durrës<sup>57</sup>.

Nga vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës ka rezultuar se për këtë çështje Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.5.2016, ka vendosur: “Rrëzimin e padisë së paditësit B. S. kundër të paditurve ATP Tiranë, N. F. dhe A. T. si të pa bazuar në ligj”.

Paditësi B. S. e ka ankimuar këtë vendim në Gjykatën e Apelit Durrës.

Gjykata e Apelit Durrës, e përbërë nga trupa gjyqësore me kryesues Valbon Çekrezi dhe anëtarë M. M. dhe D. A., me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.10.2017, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 30.5.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës”.

Gjykata e Apelit Durrës në vendimin e saj ka arsyetuar se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është rezultat i respektimit të normave procedurale, si dhe i zbatimit të drejtë të ligjit material dhe, si i tillë, duhet lënë në fuqi në zbatim të nenit 466/a të Kodit të Procedurës Civile. Çështja është për gjykim në Gjykatën e Lartë.

**11.1.2** Komisioni ka administruar përgjigjet e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (PPKKKO)<sup>58</sup>, e cila konfirmon se pranë saj është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, i vitit 2019, regjistruar për veprën penale “korrupsion aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë” me palë B. S. etj., dhe ky procedim ndodhet në fazën paraprake të hetimeve. Kjo prokurori konfirmon se shtetasi Valbon Çekrezi nuk rezulton të jetë përmendur në shpjegimet e kallëzuesit B. S., që të ketë kërkuar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë shuma parash. Gjyqtari Valbon Çekrezi rezulton të jetë një nga anëtarët e trupës gjyqësore që ka dhënë vendimin nr. \*\*\*, datë 5.10.2017, të Gjykatës së Apelit Durrës. Gjithashtu, për këtë subjekt nuk ka emër të regjistruar si person që i atribuohet vepra penale pasi nuk ka asnjë *indicie* se është përfshirë në afëra korruptive deri në këtë moment hetimi.

**Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi të jetë i përfshirë në çështjen penale që po hetohet nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizimit. Gjithashtu rezulton se ndryshe nga ajo që është pretenduar në kallëzimin e shtetasit B. S., Gjykata e Apelit, në vendimin e saj me kryesues subjektin Valbon Çekrezi, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës që kishte vendosur më herët me rrëzimin e padisë së paditësit B. S. Si nga vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit ashtu edhe nga provat e tjera të siguruara gjatë hetimit, nuk rezulton asnjë e dhënë që subjekti i rivlerësimit të jetë përfshirë në veprime korruptive me qëllim dhënien e një vendimi në favor të shtetasit B. S.**

**11.2** Çështje civile e vitit 2017, me palë E. M. dhe B. M.

Nga korrespondenca e kryer me Gjykatën e Apelit Durrës<sup>59</sup>, Komisionit i janë vënë në dispozicion, përveç përgjigjes edhe vendimin me palët respektive: vendimi nr. \*\*\*, datë 15.1.2019, me paditës ... disa palë, me të paditur, ndër të tjerë, shtetasit B. M., etj., dhe ndërhyrës kryesorë E. M. etj., me objekt ...

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 29.7.2010, ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesëpadisë së paditësve dhe ndërhyrësve kryesorë etj.” Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.1.2019, dhënë nga gjyqtarët A. M. kryesues, A. B. dhe T. H. anëtarë, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 29.7.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës”.

**Komisioni vëren se çështja është e vitit 2019 (dhe jo e vitit 2017 sipas *indicieve*) dhe subjekti i rivlerësimit Valbon Çekrezi nuk ka qenë pjesë e trupës gjyqësore që ka dhënë vendimin.**

<sup>57</sup>Shkresë nr. \*\*\*prot., datë 1.12.2020, e Gjykatës së Apelit Durrës.

<sup>58</sup>Shkresat nr. \*\*\*prot., datë 4.12.2020 dhe nr. \*\*\*prot., datë 19.2.2021, nga PPKKKO-ja.

<sup>59</sup>Shkresë nr. \*\*\*prot., datë 18.1.2021, e Gjykatës së Apelit Durrës.

**11.3** Çështja penale e vitit 2011 me të pandehur shtetasin Sh. M., akuzuar për veprën penale “korrupsion pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike”.

Komisioni ka administruar nga Gjykata e Apelit Durrës<sup>60</sup> vendimin penal nr. \*\*\*, datë 15.12.2011, për çështjen penale me të pandehur Sh. M, i akuzuar për veprën penale “korrupsion pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike.”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.12.2011, ka vendosur: “Deklarimin fajtor të të pandehurit Sh. M. për kryerjen e veprës penale “ushtrim të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” në dëm të shtetasit M. D. etj.

Ndaj këtij vendimi ka bërë ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në lidhje me cilësimin ligjor të veprës penale duke kërkuar deklarinin fajtor të të pandehurit Sh. M. për veprat penale të parashikuara nga nenet 259 dhe 245 të Kodit Penal. Gjatë procesit ka hequr dorë nga ankimi prokurori i apelit dhe Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, ka vendosur: “Mospranimin e ankimit të bërë ndaj vendimit nr. \*\*\*, datë 15.12.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan”.

Ky vendim është dhënë nga trupa gjyqësore me kryesues A. F. dhe anëtarë A. D. dhe P. DH.

**Komisioni vëren se çështja është e vitit 2011 (dhe jo e vitit 2017 sipas *indicieve*) dhe subjekti i rivlerësimit Valbon Çekrezi nuk ka qenë pjesë e trupës gjyqësore që ka dhënë vendimin.**

**11.4** Çështja civile me paditës D. D. dhe e paditur A. Z. me objekt “njohje atësie” e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës në datën 5.2.2014

Komisioni ka administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës<sup>61</sup> dosjen gjyqësore të çështjes në fjalë të gjykuar në të tria shkallët e gjykimit. Në seancën e datës 2.10.2014, pas kërkesës së paditësit për kryerjen e analizës së ADN-së, gjykata, me vendim të ndërmjetëm vendos: “Të marrë si provë raportin e analizës së ADN-së së paditësit D. D. dhe të miturit M. Z. Testi i ADN-së do të kryhet në spitalin obstetrik-gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” në Tiranë. Raporti i analizës së ADN-së duhet t’i paraqitet Gjykatës nga institucioni mjekësor brenda datës 3.11.2014, ora 09:00, që është seanca e radhës gjyqësore”.

Në seancën e datës 3.11.2014, gjykata vendosi pushimin e gjykimit pasi paditësi dhe përfaqësuesi i tij edhe pse kishin dijeni, nuk u paraqitën në gjykim dhe padia u depozitua përsëri nga paditësi.

Në seancën e datës 25.11.2014, gjykata ka vendosur kryerjen e analizave të ADN-së për përcaktimin e atësisë dhe i kërkon spitalit obstetrik-gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” Tiranë ta kryejë këtë analizë.

Në procesverbalin e datës 17.12.2014 është relatuar nga gjykata: “Në seancën e datës 25.11.2014 gjykata ka vendosur administrimin e provave dhe i ka kërkuar spitalit ‘Mbretëresha Geraldinë’ për të paraqitur kryerjen e analizave të ADN-së dhe ka kërkuar që të paraqiten personalisht palët për të dhënë shpjegime. Nga ana e postës është paraqitur një zarf të cilën gjykata e hap në prani të palëve dhe brenda ka raportin e analizave të ADN-së datë 3.11.2014, kryer nga dr. G.Z. dhe ky raport i vihet në dispozicion palëve. Në këtë raport përcaktohet se haptazi profilet biologjike të paditësit D. D. me fëmijën M. Z. në masën 99% dhe provohet se paditësi është i ati i fëmijës”.

Pala e paditur nuk është dakord specifikisht me marrje e procedurës, sepse nuk është bërë betimi nga një ekspert i fushës. Gjykata vendosi të administrojë raport-analizën e ADN-së.

Në këtë seancë, gjykata, me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.12.2014, ka vendosur: “Pranimin e padisë. Njohjen e paditësit D. D. si babain biologjik të fëmijës së mitur M. Z., i datëlindjes 26.10.2010. Urdhërohet ZGJC...etj.”

<sup>60</sup>Nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2021, nga Gjykata e Apelit Durrës.

<sup>61</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 4.12.2020, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Ndaj vendimit ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Durrës pala e paditur A. Z., ku kërkon prishjen e vendimit dhe kthimin për rigjykim të çështjes. Një nga shkaqet e ankimit është se: *“Gjykata ka caktuar mjekun G. Z. për të marrë provën e ADN-së, i cili sipas materialeve në dosje ka realizuar marrjen dhe përpunimin e analizës, si dhe ka përpiluar raportin përkatës. Caktimi i mjekut të sipërpërmendur është bërë në kundërshtim me ligjin pasi për marrjen kësaj prove kërkohen njohuri të posaçme në fushën e mjekësisë dhe veçanërisht atë të gjenetikës dhe duhet të ishte marrë nga një ekspert i fushës përkatëse.*

*Mjeku gjenetist nuk rezulton të jetë ekspert me cilësitë dhe karakteristikat që kërkon ligji. Po kështu, ai nuk ka bërë betimin sipas nenit 226 dhe në vijim të Kodit të Procedurës Civile, gjë që e bën si procesin e marrjes së provës ashtu edhe rezultatin e dalë prej tij krejt të pabesueshëm, në kundërshtim me ligjin dhe si pasojë të pavlefshëm për t’u përdorur me cilësinë e provës në procesin gjyqësor, objekt konflikti.*

*Marrja e materialit gjenetik nga i mituri M. Z. është bërë në kundërshtim flagrant me ligjin, pasi marrja e kësaj prove është bërë në organet e policisë, pa praninë e një psikologu, si dhe të një përfaqësuesi ligjor”.*

Gjykata e Apelit Durrës, me trupë gjyqësore kryesues gjyqtari A. F. dhe anëtarë D. A. dhe Valbon Çekrezi, me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.7.2016, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 17.12.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës”.

Gjykata e Lartë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 7.11.2017, pas kërkesës së të paditurës A. Z. për dorëheqje nga rekursi, ka vendosur: “Mospranimin e rekursit të bërë nga e paditura A. Z., kundër vendimit nr. \*\*\*, datë 26.7.2016, të Gjykatës së Apelit Durrës”.

**11.4.1** Komisioni, pas analizimit të dokumentacionit në dosje, ka konstatuar se nga Gjykata e Apelit Durrës nuk janë analizuar kundërshtimet e parashtruara nga pala paditëse në seancën e datës 12.7.2016, që kanë të bëjnë me anën procedurale të çështjes dhe konkretisht:

**a)** Nuk është analizuar se si Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka administruar raportin e analizës së testit të atësisë të kryer nga laboratorit “\*\*\*\*” nga dr. G.Z., pa një vendim gjyqësor, ndërkohë që më parë nga gjykata është kërkuar dhe urdhëruar që testi i ADN-së për përcaktimin e atësisë së fëmijës të bëhet nga spitali obstetrik-gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”.

**b)** Nuk është analizuar se çfarë lidhje kishte spitali obstetrik-gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” me laboratorin “\*\*\*\*” të dr. G.Z. dhe kush e ka autorizuar këtë të fundit të marrë materialin e ADN-së dhe të kryejë testin e saj.

**c)** Nuk është analizuar se me çfarë cilësie e ka kryer testin e ADN-së dr. G.Z., pa u thirrur nga Gjykata e Shkallës së Parë si ekspert i fushës, për të bërë betimin dhe për të marrë detyrat si ekspert i fushës përkatëse në kundërshtim me nenet 225, 226 e në vijim të Kodit të Procedurës Civile.

**d)** Në lidhje me marrjen e materialit të ADN-së fëmijës M. Z., nuk është analizuar shkelja e të drejtave të fëmijëve në kundërshtim me nenin 6 të Kodit të Familjes, ndër të tjera, parashikohet se: *“I mituri duhet të pyetet vetë, nëpërmjet një avokati ose një personi të zgjedhur prej tij.... prania e psikologut është e detyrueshme”.*

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**11.4.2** Në prapësimet e tij dhe në seancën dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar, ndër të tjera, se në gjykimin e çështjes në shkallë të parë është administruar edhe raporti i analizës së testit të atësisë datë 3.4.2014, kryer nga gjenetisti prof. as. dr. G.Z., ndërsa raporti mban vulën e laboratorit “\*\*\*\*”. Në çështjen konkrete për sqarimin e rrethanave dhe fakteve që kishin të bënin me mosmarrëveshjen objekt gjykimi, ka qenë i domosdoshëm tërheqja e mendimit të një eksperti me njohuri të posaçme në fushën e gjenetikës, degë e shkencës së biologjisë që studion gjenet, trashëgiminë dhe ndryshimin e organizmave, duke u ndodhur kështu në kushtet e nenit 224/a të

Kodit të Procedurës Civile. Prof. as. dr. G.Z., mendimi i të cilit është tërhequr nga gjykata, duke qenë gjenetist, konsiderohet se ka njohuri të posaçme në fushën e gjenetikës, duke përmbushur kështu kushtet për të qenë ekspert në çështjen konkrete. Prof. as. dr. G.Z. ka qenë drejtues i Qendrës së Diagnostikës Molekulare dhe Kërkimeve Gjenetike në Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, spital të cilit i është drejtuar gjykata e shkallës së parë.

Procedura për marrjen e kësaj prove, ku përfshihet edhe procedura e ndjekur për ekspertin, siç mund të vërehet ka filluar në gjykimin e mëparshëm të pushuar, ndërkohë që administrimi si provë e mendimit të ekspertit është bërë gjatë gjykimit të filluar më pas, në kuptim të nenit 300 të Kodit të Procedurës Civile. Në gjykim, pala e paditur nuk ka shfaqur pretendime në lidhje me mendimin e ekspertit, por vetëm për procedurën e caktimit të tij, çka në fakt është realizuar në gjykimin e mëparshëm të pushuar. Subjekti sjell në vëmendje se prof. as. dr. G.Z. ka qenë gjenetist i njohur, të cilin gjykatat vazhdimisht e thërrisnin si ekspert gjenetist në çështje ku kërkohesh bërja e analizës së ADN-së, ndaj pasja e cilësive të posaçme prej tij në fushën e gjenetikës është një rrethanë e pakundërshtueshme.

Ndërsa në lidhje me problematikën e moszbatimit të nenit 6 të Kodit të Familjes, subjekti shpjegon se ky nen e ka burimin nga neni 54 i Kushtetutës ku garantohet trajtimi i veçantë nga ana e të miturve. Prezenca e detyrueshme e psikologut kërkohet detyrimisht në çdo procedurë administrative dhe gjyqësore në të cilën i mituri duhet të shprehë mendimin e tij. Në rastin kur i mituri duhet të paraqitet për të realizuar marrjen e materialit gjenetik, për të kryer analizat, për të realizuar këqyrjen e personit apo për të kryer veprime të tjera, në të cilat nuk kërkohet marrja e të dhënave nga perceptimi i tij organet proceduese duhet të mjaftohen vetëm me garancinë e shoqërimit nga kujdestari ligjor, ndaj sjell në vëmendje se në rastin konkret i mituri është shoqëruar nga gjyshi i tij (nga nëna) për të kryer procedurën e marrjes së materialit biologjik dhe se në këtë procedurë mjekësore ekspertize nuk ka pasur asnjë veprim të kryer për marrjen e pëlqimit apo deklarimeve të të miturit dhe, se për rrjedhojë, nuk ka pasur as nevojë që të caktohet një ekspert tej garancisë së pranisë së gjyshit të tij. Subjekti shpjegon se e paditura ka hequr dorë nga rekursi, pasi e kishte humbur interesin për çështjen duke pranuar zgjidhjen e çështjes pikërisht duke u bazuar në aktin e ekspertit G.Z.

Subjekti ka depozituar si provë në mbështetje të shpjegimeve të tij vërtetimin<sup>62</sup> lëshuar nga spitali universitar obstetrik-gjinokologjik “Mbretëresha Geraldinë”, i cili vërteton se z. G.Z. ka qenë punonjës në institucion me detyrë gjenetist në Qendrën e Diagnostikës Molekulare për periudhën 23.3.2004 – 2020, si dhe vendime gjyqësore<sup>63</sup> ku konfirmohet fakti se z. G.Z. thirrej nga gjykatat si ekspert gjenetist pranë spitalit universitar “Mbretëresha Geraldinë” ose/dhe pranë klinikës “\*\*\*”.

## Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

**11.4.3** Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit, me shpjegimet dhe provat e depozituara prej tij, ka shpjeguar dhe provuar faktin se z. G.Z. ka qenë ekspert gjenetist për shkak të shkollimit dhe profesionit, pranë spitalit universitar “Mbretëresha Geraldinë” dhe pranë laboratorit “\*\*\*” dhe thirrej si ekspert nga gjykatat për të bërë analizat e ADN-së në çështjet gjyqësore që kishte të bënte me “njohje atësie”.

Por trupa gjyqësore e Gjykatës së Apelit Durrës dhe vetë subjekti i rivlerësimit si anëtar i saj nuk ka treguar kujdesin e duhur për të kryer verifikimin e ligjshmërisë/konstatimin e shkeljeve, në hapat proceduralë të ndërmarrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe të procedonte më tej

<sup>62</sup>Vërtetim të lëshuar nga spitali universitar obstetrik-gjinokologjik “Mbretëresha Geraldinë”, i cili vërteton se z. G.Z. ka qenë punonjës në institucion me detyrë gjenetist në Qendrën e Diagnostikës Molekulare për periudhën 23.3.2004 – 12.9.2013 dhe në periudhën 2013 – 2020 ka qenë shef i Qendrës së Diagnostikës Molekulare.

<sup>63</sup>Vendimi nr. \*\*\*, datë 29.1.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; vendimi nr. \*\*\*, datë 12.12.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; vendimi nr. \*\*\*, datë 6.10.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; vendimi nr. \*\*\*, datë 9.6.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor i Tiranë; vendimi nr. \*\*\*, datë 20.6.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

me korrjimin e tyre në përputhje me ligjin. Në vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës dhe në dosjen përkatëse, pavarësisht se është marrë vendim për kryerjen e analizës së ADN-së së fëmijës, pavarësisht se kjo analizë është një provë shkencore e realizuar nga një ekspert i fushës së gjenetikës, rezultati i së cilës vlerësohet se është aq i saktë sa nuk mund të jetë objekt hamendësimi apo interpretimi nga palët në proces, nuk rezulton të jetë marrë vendim për caktim eksperti gjenetist, nuk rezulton të jetë bërë betimi përpara gjykatës nga ana e tij, mbetet i paqartë administrimi i aktekspertimit nga gjykata e shkallës së parë, për arsye se gjykata i është drejtuar zyrtarisht për kryerjen e analizës spitalit universitar “Mbretëresha Geraldinë”, ndërkohë që përgjigja ka ardhur nga klinika “\*\*\*\*”, si edhe marrja e materialit gjenetik tek i mituri rezulton të jetë kryer pa praninë e psikologut.

**Komisioni, pasi mori në analizë provat dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, përgjatë hetimit dhe në seancë dëgjimore, pavarësisht se ky proces gjyqësor ka përfunduar edhe në Gjykatën e Lartë me mospranimin e rekursit për shkak të dorëheqjes nga rekursi të së paditurës, vlerëson se trupa gjyqësore e Gjykatës së Apelit Durrës, anëtar i së cilës ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit Valbon Çekrezi, nuk ka verifikuar dhe më pas korrigjuar gabimet procedurale në vendimmarrjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në zbatim të dispozitave përkatëse të K.Pr.Civile, si gjykatë më e lartë, si dhe nuk u ka dhënë përgjigje të gjitha pikave të ankimit të së paditurës, për rrjedhojë, në zbatim të pikës 4 nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, vlerëson se vendimi nr. \*\*\*\*, datë 26.7.2016, i Gjykatës së Apelit Durrës duhet të përcillet pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore nga ana e subjektit të rivlerësimit.**

## **DENONCIME NGA PUBLIKU**

**12.** Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Valbon Çekrezi janë administruar 19 denoncime/ankesa nga publiku, si vijojnë:

- 1) nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2017, nr. \*\*\* prot., datë 22.5.2019 dhe nr. \*\*\* prot., datë 28.7.2020 të shtetasit S. T., i cili kërkon që subjekti i rivlerësimit të veprojë sipas ligjit, por pa specifikuar ndonjë shkelje konkrete nga ana e subjektit;
- 2) nr. \*\*\* prot., datë 12.12.2017, i shtetasit I. Ç., i cili përmend subjektin e rivlerësimit në denoncim, por nuk specifikon shkeljen e bërë nga subjekti;
- 3) nr. \*\*\* prot., datë 24.5.2018, i shtetasit N. P., i cili nuk ngre ankesë specifike për subjektin Valbon Çekrezi, por për kryesuesin e trupës gjyqësore që ka gjykuar çështjen e denoncuesit, ku edhe subjekti ka qenë pjesë e saj;
- 4) nr. \*\*\* prot., datë 9.7.2018, i shtetasit B. F., i cili nuk ka ngritur ankesë specifike për subjektin Valbon Çekrezi, por shkruan për padrejtësitë që i janë bërë nga vendimet gjyqësore në të gjitha shkallët ku rezulton humbës, ku përfshihet dhe vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës dhe subjekti Valbon Çekrezi ka qenë pjesë e trupës;
- 5) nr. \*\*\* prot., datë 22.1.2019, i shtetasit E. M., i cili i referohet korrupsionit në drejtësi duke përmendur 21 subjekte përfshirë edhe subjektin Valbon Çekrezi, pa specifikuar ndonjë rast apo shkelje konkrete nga subjekti i rivlerësimit;
- 6) me nr. \*\*\* prot., datë 27.5.2020, i shoqatës N....., e cila ankohet për relatorin e çështjes se nuk ka zbardhur në kohë vendimin. Subjekti është përmendur si anëtar trupi i vendimit që është marrë nga Gjykata e Apelit Durrës, por ai nuk ka qenë në rolin e relatorit.

Komisioni, pasi mori në shqyrtim ankesat e mësipërme, konstaton se nuk referohen fakte apo rrethana konkrete për shkelje të bëra nga subjekti i rivlerësimit, për korrupsion, veprime të padrejta, rrethana të cilat mbeten të paprovuara dhe, si të tilla, nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni.

**Komisioni arrin në përfundimin se në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, këto denoncime nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova që ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.**

7) nr. \*\*\*, datë 22.5.2019, i shtetasit S. T., që ka të bëjë me vendimmarrjen pasi denoncuesi ngre ankesë ndaj gjithë subjekteve që me vendimet e tyre të të gjitha shkallëve kanë marrë vendime kundër ankuesit. Pjesë e ankimit është edhe subjekti Valbon Çekrezi, i cili ka qenë pjesë e trupës gjyquese për një vendim të dhënë;

8) nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2017, i shtetasit B. H., i cili ankohet ndaj vendimmarrjes së Gjykatës së Apelit Durrës, ku subjekti ka qenë anëtar i trupës, vendim i cili ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhënë kundër një të afërmi të tij;

9) nr. \*\*\* prot., datë 27.4.2018, i shtetasit H. M., i cili ankohet për vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit ku subjekti Valbon Çekrezi ka qenë anëtar trupe. Arsyeja është përse kjo trupë ka vendosur transferimin e çështjes në Gjykatën e Lartë duke zvarritur çështjen. Ka rezultuar se Gjykata e Lartë i ka dhënë të drejtë Gjykatës së Apelit në këtë çështje duke e përcjellë atë në gjykatën e shkallës së parë;

10) nr. \*\*\* prot., datë 9.7.2018, i shtetasit E. Rr., i cili ankohet për subjektin Valbon Çekrezi për dhënie vendimi të padrejtë së bashku me anëtarët e tjerë të trupës gjyqësore. Sipas denoncuesit, subjekti Valbon Çekrezi nuk duhet të merrte pjesë në këtë proces pasi ka gjykuar më përpara procese të tij. Komisioni vëren se ndërmjet vendimit të çështjes së parë, dhënë në vitin 2004 dhe çështjes së dytë, dhënë në vitin 2017 ka një diferencë të gjatë kohore prej 14 vjetësh. Komisioni vëren se të dyja çështjet kanë të njëjtat palë, por në pozita juridike të ndryshme, po kështu objekti i padisë në të dyja çështjet është i ndryshëm. Nga përmbajtja e vendimeve si dhe nga vetë denoncuesi nuk gjejmë të relatuar nëse nga denoncuesi është bërë kërkesë për përjashtim të subjektit nga procesi gjyqësor.

11) nr. \*\*\* prot., datë 11.7.2018, i shoqërisë A..., e cila ankohet ndaj trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Durrës, përfshirë edhe subjektin për vendime të padrejta dhe abuzive në disfavor të shoqërisë A...;

12) nr. \*\*\* prot., datë 29.10.2018, të shtetasve N. K. dhe S. V., të cilët ankohen ndaj gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Durrës, përfshirë edhe subjektin Valbon Çekrezi për vendim të padrejtë, pasi ka ndryshuar një vendim të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë në favor të denoncuesve;

13) nr. \*\*\* prot., datë 10.2.2019, i shtetasit E. M., i cili ankohet për vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit Durrës, ku subjekti Valbon Çekrezi ka qenë anëtar trupe dhe me këtë vendim kanë lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, e cila kishte vendosur kundër denoncuesit.

14) nr. \*\*\* prot., datë 8.3.2019, i shtetasit N. H., i cili ankohet për vendimin e marrë nga Gjykata e Apelit Durrës për një çështje të gjykuar nga subjekti i rivlerësimit Valbon Çekrezi me dy anëtarë të tjerë të trupës, vendim i cili ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, dhënë kundër denoncuesit;

15) nr. \*\*\* prot., datë 4.6.2020, i shtetasit O. M., i cili ankohet ndaj subjektit Valbon Çekrezi si relator i çështjes ku janë bërë shkelje të rënda të normave procedurale, pasi ka prishur vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhënë në favor të denoncuesit;

16) nr. \*\*\* prot., datë 16.6.2020, i shtetasit R. D., i cili ankohet se ligji nuk është zbatuar me korrektësi pasi Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin e saj të dhënë nga trupa gjyquese ku subjekti i rivlerësimit Valbon Çekrezi ka qenë pjesë e saj, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhënë kundër të tyre.

**12.1** Komisioni, pasi mori në shqyrtim ankesat e mësipërme, konstaton se pretendohen fakte që kanë lidhje me vendimmarrjen dhe themelin e çështjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, rrethana të cilat nuk provohen dhe, si të tilla, nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni.

**Komisioni arrin në përfundimin se për ankesat e lartpërmendura mban parasysh nenin 72<sup>64</sup> të ligjit nr. 96/2016, që ka të bëjë me themelin e çështjes dhe interpretimin e logjikës së gjyqtarit.**

**12.2** Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2019 i shtetasit XH. K., i cili ankohet për subjektin e rivlerësimit për shkelje ligjore duke zvarritur çështjen se nuk ka dërguar asnjë fletëhirrje as në shtëpi, as *online* dhe as nuk i ka dërguar ndonjëherë njoftim.

Komisioni ka administruar vendimin nr. \*\*\*, datë 24.10.2019, të Gjykatës së Apelit Durrës<sup>65</sup>, nga ku rezulton çështja civile me palë paditëse XH. K. dhe i paditur N. K. me objekt “detyrimin e të paditurve të më njohin investues dhe posedues duke më njohur të gjitha të drejtat (pronar) mbi objektet informale me sip. 67 m<sup>2</sup> të ngritura nga unë në parcelën ndërtimore nr. pasurie \*\*\*, me sip. 188 m<sup>2</sup>, ndodhur në z. k. \*\*\*, L. P., Sh., Durrës”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 31.10.2017, ka vendosur: “Rrëzimin e padisë”.

Gjykata e Apelit Durrës, me trupë gjyqësore subjektin si kryesues, me vendimin e saj ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit civil nr. \*\*\*, datë 31.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës” me arsyetimin se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është rezultat i një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, si dhe i vlerësimit të drejtë të ligjit material dhe procedural.

Komisioni ka administruar dosjen gjyqësore nga Gjykata e Lartë<sup>66</sup> ku janë aktet e gjykimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe të Gjykatës së Apelit. Nga dosja e Gjykatës së Apelit rezulton se nga regjistri i veprimeve, më 20.8.2018 ka ndryshuar gjyqtari i çështjes P. Ç. dhe pas rishortimit gjyqtari i ri është caktuar Valbon Çekrezi.

Nga dokumentacioni në dosje rezulton se njoftimet e shtetasit Xh. K. janë bërë rregullisht për çdo seancë.

**12.3** Komisioni vëren se:

i) Për sa i përket pretendimit të zvarritjes së procesit gjyqësor nga ana e subjektit të rivlerësimit me cilësinë e relatorit të çështjes, vihet re se seancat gjyqësore janë shtyrë me shkaqe të përligjura. Rezulton se denoncuesi, me cilësinë e paditësit, ka pasur dijeni rregullisht për çdo seancë dhe është paraqitur në seancat e zhvilluara nga gjykata.

Nuk qëndrojnë pretendimet e denoncuesit dhe subjekti nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi disiplinore, referuar kriterit profesional.

ii) Në lidhje me kohëzgjatjen e gjykimit, shorti ka përcaktuar për gjykimin e çështjes subjektin Valbon Çekrezi më 20.8.2018, ndërkohë që nga ky i fundit është caktuar seanca e parë gjyqësore në datën 11.6.2019, pra pas afërsisht 10 muajsh nga data e regjistrimit dhe në total kohëzgjatja e gjykimit është jashtë afatit standard kohor 6-mujor, të përcaktuar nga germa “g”, e pikës 5, të Aneksit I, të Sistemit të Vlerësimit.

Komisioni, në lidhje me konstatimin në pikën (ii) i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

**Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

<sup>64</sup>Pika 4 e nenit 72: “Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet”.

<sup>65</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 22.12.2020, e Gjykatës së Apelit Durrës.

<sup>66</sup>Dosja e përcjellë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.1.2021, e Gjykatës së Lartë.



**12.4** Subjekti i rivlerësimit ,në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar, ndër të tjera, se planifikimi për gjykim i çështjes pas rreth 10 muajsh nga data e regjistrimit ka ardhur si pasojë e ngarkesës në punë në Gjykatën e Apelit Durrës, e cila në vijimësi ka pasur një numër të lartë çështjesh, ndërsa organika ka qenë e mangët për shkak të pezullimit të 3 gjyqtarëve të kësaj gjykate. Subjekti shpjegon se rrethanat e rastit që kanë çuar në atë kohëzgjatje të gjykimit të asaj çështjeje civile, janë objektive dhe të pavarura nga ai si gjyqtar, prandaj ajo nuk duhet të konsiderohet si një e dhënë negative për vlerësimin e tij profesional.

Subjekti ka depozituar edhe vërtetimin e datës 20.5.2021 të kryesekretarisë së kësaj gjykate ku jepen të dhënat statistikore për çështjet e gjykuara nga subjekti Valbon Çekrezi për vitin 2018 - 2019.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

**12.5** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me këtë konstatim, duke u konsideruar mungesa e 3 gjyqtarëve si arsye objektive për kohëzgjatjen e çështjes në fjalë jashtë afateve ligjore për arsye që nuk varen nga gjyqtari.

**Komisioni vëren se vonesa në kohëzgjatjen e kësaj çështjeje për arsye objektive të pavarura nga subjekti i rivlerësimit, nuk përbën shkak të vetëm që mund të çojë në një vlerësimin negativ të subjektit në lidhje me kriterin profesional.**

## **VLERËSIMI I ÇËSHTJES NGA TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

Trupi gjykues, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, kreut IV dhe nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit Valbon Çekrezi:

a. Ka kryer deklaram të mjaftueshëm dhe në vlerësim tërësor të saktë të pasurisë, duke konstatuar pasaktësi të karakterit minimal.

Nga analiza financiare rezulton se me të ardhurat e fituara ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të blerë pasuritë, për të krijuar likuiditetet dhe për të kryer të gjitha shpenzimet e jetesës të evidentuara gjatë periudhës së rivlerësimit 2003 – 2016, në shumën 626,099 lekë të cilën Komisioni, në bazë të parimit të proporcionalitetit e vlerëson si vlerë minimale, duke mos prodhuar pasoja të tilla, që mund të çojnë në konkluzionin se ndodhet përpara një deklarimi të pamjaftueshëm dhe, për rrjedhojë, në aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra referuar nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

b. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, kreut V, të ligjit nr. 84/2016 , lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit Valbon Çekrezi ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

c. Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se dërgimi për inspektim i një prej dosjeve të gjykuara nga subjekti, arsyetuar në pikën 4.6, është e pamjaftueshme<sup>67</sup> për të arritur në vlerësimin e tij “me mangësi”. Në këto kushte, referuar

<sup>67</sup>Pika 1, e nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, i cili përcakton se: “Vlerësimi i aftësive profesionale ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale, që mund të korrigjohen përmes edukimit”; neni 59 i ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit: “Vlerësimi i aftësive profesionale parashikon arritjen e një niveli minimal kualifikues”; vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese, ku në pikën 54 përcaktohet se: “... në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht ‘të pasakta’ nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjyqimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale” (shihni edhe opinionin CDL -AD (2016)036 të Komisionit të Venecias).

nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, pas propozimit të relatorit, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të gurmës “a”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikave 1 dhe 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Valbon Çekrezi, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës.
2. Transferimin e çështjes gjyqësore që i përket vendimit nr. \*\*\*, datë 26.7.2016, të Gjykatës së Apelit Durrës, në organin kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore bazuar në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 7.6.2021.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Brunilda BEKTESHI**  
Kryesuese

**Olsi KOMICI**  
Relator

**Roland ILIA**  
Anëtar

*Sekretare gjyqësore*  
*Olsida Goxhaj*